



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.10

24 shkurt

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.81, datë 13.2.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare, në formën e një huaje afatshkurtër, dhe për miratimin e kushteve të huas.....	441
Vendim i KM nr.109, datë 15.2.2012	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Brendshme dhe te Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, për Drejtorinë Rrugore Shkodër, të disa objekteve e të truallit funksional, pjesë të pronës nr.426, me emërtim “Shtabi i Brigadës së Artilerisë”, me vendndodhje në Rrenc, Shkodër, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.....	443
Vendim i GJK nr.4, datë 10.2.2012	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.72, datë 4.12.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; vendimit nr.14, datë 15.2.2010 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; vendimit nr.00-2010-1356 (971), datë 8.11.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).....	445
Vendim i GJK nr.5, datë 16.2.2012	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të fjalisë “Në këtë rast gjyqtari mund të transferohet edhe në institucionet e parashikuara në nenin 28/1 të këtij ligji, duke përfutuar pagesën e gjyqtarit”, si dhe të shprehjes “ose më të ulët” të nenit 42/1, të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.....	456
Vendim i GJK nr.6, datë 17.2.2012	Me objekt zgjidhjen e konfliktit ligjor ndërmjet vendimit unifikues nr.12, datë 14.9.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe akteve të tjera ligjore në fushën e sigurimeve.....	465

VENDIM
Nr.81, datë 13.2.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, PËR KORPORATËN
ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE, NË FORMËN E NJË HUAJE AFATSHKURTËR, DHE
PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE TË HUAS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në programin “Mbështetje për energjinë”, zëri “Transferta”, t’i shtohet fondi 2 000 000 000 (dy miliardë) lekë, për shoqërinë me kapital 100 për qind shtetëror, Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare, në formën e një huaje afatshkurtër.

2. Kushtet e huas janë të përcaktuara në projekt marrëveshjen që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Fondi sipas pikës 1 të këtij vendimi, të përballohet nga Fondi i Kontigjencës, i miratuar në buxhetin e shtetit të vitit 2012.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE HUAJE

Datë 16.2.2012

**NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE (HUADHËNËSI) DHE KORPORATA
ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE (HUAMARRËSI)**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.81, datë 13.2.2012, Ministria e Financave dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) lidhin Marrëveshjen e huas, si më poshtë:

Neni 1

Ministria e Financave ka rënë dakord t’i huazojë KESH-it deri në 2 000 000 000 (dy miliardë) lekë.

Neni 2

KESH do ta përdorë shumën e huas së përcaktuar në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje huaje për sigurimin e energjisë elektrike nga importi.

Neni 3

KESH ka të drejtë të tërheqë fondet e huas nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit.



Neni 4

Afati i maturimit të huas është 6 muaj nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. KESH do të shlyejë principalin e huas në një këst të vetëm, në fund të periudhës së maturimit.

Neni 5

KESH do të paguajë një interes në masën 0.5% në vit, mbi bazën e principalit të huas së disbursuar. Llogaritja e interesit do të bëhet mbi bazën e numrit faktik të ditëve dhe të vitit prej 360 ditësh. Pagesa e interesit do të kryhet në të njëjtën datë me pagesën e principalit.

Neni 6

Nëse KESH nuk do të kryejë pagesat e përcaktuara në nenet 4 e 5 të kësaj Marrëveshjeje huaje, do t'i paguajë Ministrisë së Financave interesvonesa mbi shumën e detyrimeve të papaguara, në përqindje të barabarta me “Yeldin Mesatar të Bonove të Thesarit, 1-vjeçare, të rezultuar në ankandin e fundit të vitit 2011”.

Neni 7

Në rast të shlyerjes së parakohshme të huas, nuk do të aplikohen penaltete nga ana e Ministrisë së Financave.

Neni 8

Në rast mosshlyerjeje të detyrimit, Ministria e Financave rezervon të drejtën e konfiskimit të të ardhurave nga shitja e energjisë elektrike.

Neni 9

Kjo Marrëveshje huaje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe mbetet në fuqi deri sa palët të shlyejnë të gjitha detyrimet reciproke që kanë kundrejt njëri-tjetrit, mbi bazën e saj.

Palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, nënshkruajnë këtë Marrëveshje huaje, në datën 16.2.2012, në Tiranë.

Kjo Marrëveshje huaje nënshkruhet në dy kopje origjinale, një për secilën palë.

PËR MINISTRINË E FINANCAVE

Ministri
Ridvan Bode

PËR KESH SHA

Drejtor i Përgjithshëm
Engjëll Zeqo

VENDIM
Nr.109, datë 15.2.2012

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTERIA E MBROJTJES TE
MINISTERIA E BRENDSHME DHE TE MINISTERIA E PUNËVE PUBLIKE DHE
TRANSPORTIT, PËR DREJTORINË RRUGORE SHKODËR, TË DISA OBJEKTEVE E TË
TRUALLIT FUNKSIONAL, PJESË TË PRONËS NR.426, ME EMËRTIM “SHTABI I
BRIGADËS SË ARTILERISË”, ME VENDNDODHJE NË RRENC, SHKODËR, DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE,
TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Brendshme, të disa objekteve dhe të truallit funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 28 170.3 (njëzet e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë pikë tre) m², pjesë e pronës nr.426, me emërtim “Shtabi i Brigadës së Artilerisë”, me vendndodhje në Rrenc, Shkodër, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, për t’i përdorur si qendër akomodimi të popullsisë së evakuuar, stacion magazinimi dhe për shpërndarje të rezervave për plotësimin e nevojave të komunitetit, në rastet e fatkeqësive natyrore në zonën e Shkodrës.

2. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, për Drejtorinë Rrugore Shkodër, të disa objekteve dhe të truallit funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 2 381.8 (dy mijë e treqind e tetëdhjetë e një pikë tetë) m², pjesë e pronës nr.426, me emërtim “Shtabi i Brigadës së Artilerisë”, me vendndodhje në Rrenc, Shkodër, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, për t’i përdorur për zyra, për plotësimin e nevojave të administratës së Drejtorisë Rrugore Shkodër.

3. Prona nr.426, me emërtim “Shtabi i Brigadës së Artilerisë”, me vendndodhje në Rrenc, Shkodër, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.


4. Dorëzimi i mjediseve dhe i truallit funksional të pronës të bëhet pas heqjes së materialeve dhe të pajisjeve të Forcave të Armatosura, të magazinuara në këtë pronë.

5. Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit u ndalohej ta ndryshojnë destinacionin e përcaktuar në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.


6. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



PLAN VENDOSJA E ISH REP.USHT. NR. 1190
(PRONA NR.426)
RENCË SHKODER



PUNOI
Top.Dashnor HYSI
Top.Qemal HOXHA
PERGJ. I DEP. TE GJEOMATIKES
Ramiz HAXHTU



VENDIM
Nr.4, datë 10.2.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“

me sekretare Enina Mullaj, në datën 1.11.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer te hapura, çështjen nr. 44/19 Akti, që i përket:

KËRKUES: Leonard Luzi, përfaqësuar nga avokat Saimir Vishaj, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr.72, datë 4.12.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; vendimit nr.14, datë 15.2.2010 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; vendimit nr.00-2010-1356 (971), datë 8.11.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 31/a, 42/2, 43, 131/f, 134/1/g, 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ); ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, përfaqësuesin e kërkuarit që u shpreh për pranimin e kërkesës dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari është akuzuar për veprën penale të “moskallëzimit të krimit” të parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal (KP).

2. Sipas kërkesës të paraqitur nga kërkuari dhe mbrojtësi i tij, nga gjykatat është proceduar me gjykim të shkurtuar.

3. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, bazuar në nenin 375 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ka çmuar të ndryshojë cilësimin juridik të veprës penale dhe me vendimin nr.72, datë 4.12.2009, ka vendosur, ndër të tjera, deklarinimin fajtor të kërkuarit për veprën penale të “trafikimit të narkotikëve”, të kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/2 dhe 22 e 23 i KP-së dhe e ka dënuar atë me 9 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të KPP-së ka dënuar kërkuarin, përfundimisht, me 6 vjet burgim.

4. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuari dhe mbrojtësi i tij, si dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Kjo e fundit ka kërkuar, gjatë gjykimit, heqjen dorë nga ankimi, i cili është pranuar nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda.

5. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr.14, datë 15.2.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.72, datë 4.12.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.



6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi), me vendimin nr.00-2010-1356 (971), datë 8.11.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, pasi ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

II

Pretendimet e palëve parashtruar Gjykatës Kushtetuese

7. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, si dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtimit e mëposhtme:

7.1. *Është cenuar e drejta e mbrojtjes* pasi, me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga ana e gjykatës gjatë procedimit me gjykim të shkurtuar, kërkuesit i është mohuar e drejta për t'u mbrojtur ndaj formulimit të ri të veprës penale.

7.2. *Është cenuar e drejta e për t'u vënë në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën e ngritur*, e sanksionuar nga neni 31/a i Kushtetutës, pasi me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, kërkuesit nuk i është komunikuar akuza për veprën e re penale, të ndryshme nga ajo e paraqitur nga prokurori në kërkesën për gjykim.

7.3. Si rezultat i dy pretendimeve të lartpërmendura, kërkuesi është dënuar pa u gjykuar. Në këtë kontekst, nëse ai do të akuzohej për veprën penale të “trafikimit të narkotikëve”, të kryer në bashkëpunim, do të kërkonte ndryshimin e llojit të gjykimit.

7.4. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka gabuar duke bërë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale gjatë procedimit me gjykimin të shkurtuar, pasi ajo ka aplikuar rregullat e gjykimit të zakonshëm të parashikuara në KPP (neni 375 i KPP-së) në një gjykim të posaçëm. Në këtë mënyrë ajo ka marrë rol aktiv dhe është bërë palë në proces, dhe jo subjekt për dhënien e drejtësisë.

7.5. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda nuk ka respektuar nenin 142/1 të Kushtetutës që sanksionon detyrimin e arsytimit të vendimit, pasi vendimi i kësaj gjykate nuk është arsyetuar në mënyrë të përshtatshme dhe është kontradiktor në lidhje me kryerjen në bashkëpunim nga kërkuesi të veprës penale të “trafikimit të narkotikëve”.

7.6. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka gabuar duke bërë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, pasi ky ndryshim i shtrin efektet brenda faktit për të cilin i pandehuri akuzohet, ndërsa dy veprat penale në shqyrtim, parashikuara nga nenet 282/a/2 dhe 300 i KP-së, kanë objekte të figurës së krimin diametrisht të kundërta.

8. ***Prokuroria e Përgjithshme*** me shkresën nr.3037/3 Prot., datë 31.10.2011, drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë të përmbledhur ka parashtruar se:

8.1. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë zhvilluar një proces të rregullt ligjor, duke kryer secila rolin që i përcakton Kushtetuta dhe ligji në dhënien e drejtësisë. Gjykata e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit për Krime të Rënda, në kuptim dhe zbatim të drejtë të nenit 11, 375, 403-406 e vijues të KPP-së dhe nenit 145/1 të Kushtetutës, në ritualin e gjykimit të shkurtuar, kanë realizuar dhënien e drejtësisë, duke bërë ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale ndaj kërkuesit. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke gjetur të pabazuara në shkaqet ligjore që parashikon neni 432 i KPP-së pretendimet e kërkuesit ndaj vendimeve të dy gjykatave, me të drejtë, dhe bazuar në nenin 433 të KPP-së, ka vendosur mospranimin e rekursit.

8.2. Kërkuesit i është garantuar e drejta e mbrojtjes, pasi vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda që ndryshoi cilësimin juridik të veprës penale ndaj tij është apeluar dhe rekursuar nga ky i fundit. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë vepruar në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila në vendimet nr.50, datë 30.7.1999 dhe nr. 24, datë 30.7.2003 ka përcaktuar se: *“Kuptimi në këtë mënyrë i përmbajtjes së nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale i shërben dhënies së drejtësisë, sepse në të kundërtën ajo do të vepronte në kundërshtim me provat dhe me ligjin. Në rast se gjykata nuk do të bënte një cilësim të drejtë të veprës penale, vendimi i saj do të prishej nga gjykata më e lartë për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Pra, edhe në këtë aspekt, gjykata është e detyruar të bëjë*

vetë ndryshimin e cilësimit të veprës kur ky është i ndryshëm nga ai i prokurorit” dhe se “Gjykata, duke i dhënë faktit një përcaktim juridik të ndryshëm nga ai i prokurorit, mund të bëjë që cilësimi i ri të jetë një veprë penale më e lehtë ose më e rëndë. Në rastin e fundit nuk do të thotë se rëndohet pozita e të pandehurit. Rëndimi i pozitës trajtohet në raport me shkallën më të lartë të gjyqimit. Kur gjykata bën cilësimin e drejtë ligjor të veprës, pavarësisht nga karakteri i saj më i rëndë, ajo ka bërë një zbatim të drejtë të ligjit dhe duke vënë në dijeni palët u krijon atyre mundësinë për t’u ankuar ndaj vendimit”.

8.3. Pretendimet e kërkuarit për analizë e vlerësim provash, zbatim të ligjit penal apo cilësim juridik të veprës penale dhe zbatim të ligjit procedural penal nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese pasi ato nuk hyjnë në juridiksionin e saj, por kanë të bëjnë me konstatimin dhe vlerësimin e atyre çështjeve që, sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, janë në kompetencë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

8.4. Kërkuari, lidhur me pretendimin e tij se: *nëse ai do të akuzohej për veprën penale të “trafikimit të narkotikëve”, të kryer në bashkëpunim, do të kërkonte ndryshimin e llojit të gjyqimit*, nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike sipas kërkesave të nenit 131/f të Kushtetutës, pasi ky pretendim nuk është parashtruar në ankimin dhe në rekursin e ushtruar nga kërkuari.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

9. Gjykata Kushtetuese thekson, paraprakisht, se ajo i vlerëson pretendimet e kërkuarit në drejtim të standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, në aspektin e detyrimeve që i ngarkon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm respektimi i të drejtës së mbrojtjes.

10. Duke u bazuar në këto vlerësime, Gjykata Kushtetuese vëren se disa nga pretendimet e kërkuarit, përpos mënyrës së formulimit të tyre, kanë të bëjnë në thelb me themelin e çështjes që kanë pasur për gjykim gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të lidhura me vlerësimin e provave dhe mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të së drejtës materiale e procedurale penale (mënyra e kualifikimit të veprës penale, kuptimi juridik i veprës penale të “trafikimit të narkotikëve”, lloji i gjyqimit, etj.) nga këto gjykata. Gjykata Kushtetuese ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit interpretimi i ligjit material e procedural, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr.31, datë 5.7.2011; nr. 22, datë 22.7.2009 dhe nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata Kushtetuese, po ashtu, çmon se në rastin objekt shqyrtimi, në thelb të pretendimeve të kërkuarit për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor qëndron e drejta për t’u informuar për akuzën e ngritur dhe e drejta për t’u mbrojtur, prandaj, Gjykata Kushtetuese në vijim do t’i japë përgjigje këtyre parimeve kushtetuese.

A. Në lidhje me pretendimin për cenimin e të drejtës për t’u informuar për akuzën dhe e të drejtës së mbrojtjes

12. E drejta e individit për t’u vënë në dijeni menjëherë dhe në mënyrë të hollësishme mbi natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij është sanksionuar nga neni 31/a i Kushtetutës dhe nga neni 6/3/a i KEDNJ-së. Ky parim kushtetues është trajtuar nga jurisprudenca shqiptare dhe ajo e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në funksion të realizimit të së drejtës së mbrojtjes të të akuzuarit si dhe të garantimit të parimit të barazisë së armëve ndërmjet palës akuzuese dhe mbrojtjes. Gjykata Kushtetuese vëren se qëllimi i këtyre dispozitave është të krijojnë mundësinë për të akuzuarin të njihet paraprakisht me materialet, provat dhe rezultatet e hetimit, në mënyrë që të ushtrojë të drejtën e tij për të përgatitur një mbrojtje efektive, pra për të paraqitur argumentet në favor të tij dhe për të kundërshtuar akuzën e ngritur.



13. Në lidhje me të drejtën e mbrojtjes, Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj të konsoliduar ka theksuar se ajo duhet të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimet nr.37, datë 19.9.2011; nr.25, datë 10.6.2011; nr.5, datë 17.2.2003 dhe nr.33, datë 24.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në këtë këndvështrim, Gjykata Kushtetuese, po ashtu, ka theksuar se veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe lidhur ngushtë me këto, realizimi i mbrojtjes së të pandehurit, garantuar shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, përbëjnë në vetvete elementet më thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Për respektimin e këtyre parimeve, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të përmbushin një sërë detyrimesh, mes të cilave, sipas rastit, rëndësi të veçantë paraqet edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes, etj., me synimin që të realizohet një debat real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata. (*shih vendimet nr. 37, datë 19.9.2011; nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 19, datë 18.9.2008; nr. 13, datë 21.7.2008; nr. 16, datë 8.6.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Po në këtë drejtim, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, qëllimi i së drejtës për t'u informuar për akuzën, i sanksionuar nga neni 6/3/a i KEDNJ-së, është që informacioni i kërkuar t'i jepet të akuzuarit në momentin e ngritjes së akuzës, ose në momentin e fillimit të procesit gjyqësor dhe është thelbësor fakti që vepra penale për të cilën dënohet një person, është ajo për të cilën ai është akuzuar (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Pélissier dhe Sassi kundër Francës, 25 mars 1989*).

16. Nga sa më lart, Gjykata Kushtetuese vlerëson se informimi i plotë dhe i saktë për akuzat e ngritura, si dhe për kualifikimin juridik të veprës penale, duhet të konsiderohet si kusht themelor për besueshmërinë e procesit dhe për përgatitjen e duhur të një mbrojtjeje efektive, e cila është një nga garancitë themelore për realizimin e të drejtës për një proces të rregull ligjor të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së.

17. Duke iu rikthyer çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese çmon se në thelb të pretendimeve të kërkuarit për cenim të së drejtës për t'u informuar për akuzën e ngritur dhe së drejtës për t'u mbrojtur, qëndron e drejta e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për të ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale dhe për pasojë për të dënuar të pandehurin për një vepër të ndryshme, nga ajo për të cilën është akuzuar nga prokurori në kërkesën për gjykim, kur ndërkohë nga gjykata është proceduar me gjykim të shkurtuar. Për këtë arsye Gjykata Kushtetuese sheh të arsyeshme të analizojë paraprakisht dy institutet në fjalë, si më poshtë vijon.

B. Ratio e institutit të gjykimit të shkurtuar

18. Gjykimi i shkurtuar hyn në kategorinë e gjykimeve të posaçme, i cili është parashikuar nga nenet 403-406 të KPP-së. Gjykata, kur i pandehuri ka bërë kërkesë që të procedohet me këtë lloj gjykimi, nëse çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, vendos gjykimin e shkurtuar. Pra, gjykimi i shkurtuar nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit, i cili mund të refuzojë kërkesën nëse mendon se është i nevojshëm një proces i mirëfilltë penal.

19. Disa nga veçoritë/elementet e “gjykimit të shkurtuar” janë vënë në dukje në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr.2, datë 29.1.2003, sipas të cilit:

a) Gjykimi i shkurtuar ka vlerë për ekonomi gjyqësore, sepse thjeshton dhe shkurton procedurat, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimit dhe sjell si pasojë një përfitim për të pandehurin në uljen në një 1/3 e masës së dënimit dhe mosaplikimin e dënimit me burgim të përjetshëm.

b) Ky përfitim nuk duhet kurrësi të shkojë në dëm të dhënies së drejtësisë. Pra, kërkesën e të dënuarit dhe të mbrojtësit të posaçëm të tij, gjykata e pranon vetëm atëherë, kur ajo praktikisht bindet se mund të përfundojë çështjen në gjendjen që janë aktet, pa qenë nevoja për shqyrtimin gjyqësor.

20. Në këndvështrimin kushtetues, Gjykata Kushtetuese çmon se gjykimi i shkurtuar është një gjykim i posaçëm i cili konsiston në heqjen dorë në mënyrë të vullnetshme nga i pandehuri nga disa aspekte themelore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të tilla si parimi i barazisë së armëve dhe i formimit të provës në kontradiktoritet, për të përfituar një ulje dënimi. Për këtë arsye legjislatori për këtë lloj gjykimi ka parashikuar rregulla të veçanta në kreun IV të titullit VII të KPP-së (nenet 403-406), të cilave gjyqtarët duhen t'i përmbahen gjatë zbatimit të këtij gjykimi të posaçëm. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese vëren se përdorimi i rregullave të përgjithshme të gjykimit të zakonshëm në gjykimin e posaçëm bëhet, në mënyrë taksative, vetëm në rastet kur këtyre rregullave u referohen në mënyrë eksplicite dispozitat e veçanta të gjykimit të shkurtuar (p.sh. neni 406/4 i KPP-së i referohet dispozitave të kreut III të titullit VII të këtij Kodi).

21. GJEDNJ-ja ka trajtuar në disa çështje veçoritë e institutit të gjykimit të shkurtuar. Ajo, duke analizuar institutin në fjalë, ka theksuar se “*kjo procedurë paraqet avantazhe të padiskutueshme për të pandehurin: në rast dënimi, ky i fundit gëzon një ulje të dënimit* (shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjen Hermi kundër Italisë, nr.18114/02, §§ 27-28 dhe në çështjen Hany kundër Italisë, nr. 17543/05). *Kjo procedurë gjithsesi është e shoqëruar me një lehtësim të garancive procedurale të ofruara nga e drejta e brendshme, në veçanti për sa i përket publicitetit të diskutimit si dhe mundësisë që të kërkohet paraqitja e provave dhe thirrja e dëshmitarëve* (shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Kwiatkoxska kundër Italisë, nr.52868/99). *Këto garanci përbëjnë aspekte themelore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor të sanksionuar nga neni 6 i KEDNJ-së. Gjithsesi as teksti dhe as fryma e kësaj dispozite nuk ndalojnë që një person të heqë dorë në mënyrë spontane dhe të shprehur nga kjo e drejtë. Por, që të merret në konsideratë nën këndvështrimin e Konventës, kjo heqje dorë duhet të jetë e shprehur në mënyrë eksplicite dhe duhet të jetë e shoqëruar me një minimum garancish*”. Në vijim GJEDNJ-ja ka çmuar se, duke kërkuar procedimin me gjykim të shkurtuar, aplikanti ka hequr dorë në mënyrë eksplicite nga të drejtat e tij për një seancë publike, të thërrasë dëshmitarët e tij në gjykim, të paraqesë prova, në këmbim të një sërë avantazheve që atij i garantohen nga legjislacioni i brendshëm (shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Scoppola kundër Italisë, kërkesa nr. 10249/03).

22. Po në këtë aspekt, GJEDNJ-ja ka çmuar gjithashtu se “*një i pandehur duhet të presë që Shteti të veprojë në mirëbesim dhe të ketë marrë mirë parasysh zgjedhjet procedurale të mbrojtjes, duke përdorur mundësitë e ofruara nga ligji. Është kundër parimeve të sigurisë juridike dhe të mbrojtjes të besimit legjitim të personave që janë në gjykim që Shteti mund, në mënyrë të njëanshme, të ulë avantazhet që rrjedhin nga heqja dorë e disa të drejtave që kanë të bëjnë me nocionin e procesit të rregullt. Nëse kjo heqje dorë bëhet në këmbim të avantazheve të lartpërmendura, nuk mund të konsiderohet e drejtë që, pasi autoritetet e brendshme kanë pranuar të procedojnë me gjykim të thjeshtuar, një element themelor i marrëveshjes ndërmjet Shtetit dhe të pandehurit mund të modifikohet në disavantazh të këtij të fundit, pa konsensusin e tij. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, nëse është e vërtetë që Shtetet kontraktuese nuk janë të detyruar nga Konventa të parashikojnë procedura të thjeshtuara, qëndron gjithsesi fakti se, kur këto procedura ekzistojnë dhe aplikohen, parimet e procesit të rregullt ligjor imponojnë që të mos privohet në mënyrë arbitrare i pandehuri nga avantazhet që me atë procedurë lidhen* (shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Scoppola kundër Italisë, kërkesa nr. 10249/03).

23. Gjithashtu, instituti i gjykimit të shkurtuar ka qenë shpeshherë objekt shqyrtimi i Gjykatës Kushtetuese Italiane¹, e cila, në vendimin nr.140/2010 duke bërë një analizë mbi *ratio* e këtij gjykimi, është shprehur se: “*vlerësimet e të pandehurit për dobinë e gjykimeve të posaçme varen në radhë të parë nga mënyra se si është përcaktuar procesi dhe vepra penale nga prokurori. Me pasojën që kur, për ‘raste patologjike’, si gabimet ose mosveprimet e prokurorit për përcaktimin e faktit ose të veprës penale, akuza pëson një ndryshim substancial, i pandehuri duhet të rivendoset në afat për të bërë vlerësimet e duhura, me rrjedhojë, përndryshe, cenimin e të drejtës së mbrojtjes si dhe të parimit të barazisë së armëve, duke qenë se do të kishim një diskriminim sipas ‘ekzaktësisë ose plotësisë më të madhe ose më të*

¹ Modeli i institutit të gjykimit të shkurtuar në Kodin e Procedurës Penale shqiptare është huazuar nga legjislacioni italian (si pasojë e përdorimit të modelit të KPP-së italiane në hartimin e KPP-së shqiptare), prandaj Gjykata Kushtetuese e vlerëson të arsyeshme t'i referohet edhe jurisprudencës italiane në lidhje me këtë institut.



vogël të vlerësimit diskrecional të rezultateve të hetimeve paraprake nga ana e prokurorit” (shih edhe vendimet nr.333/2009 dhe nr.265/1994 të Gjykatës Kushtetuese Italiane).

24. Po në vendimin e lartpërmendur, Gjykata Kushtetuese Italiane ka theksuar se: *“Me kërkesën për gjykim të shkurtuar i pandehuri pranon të gjykohej me gjykimin e posaçëm në raport me akuzat e formuluar nga prokurori, e vetëm ndaj tyre ai shpreh vlerësimin e dobisë së këtij gjykimi; kështu që nuk do të ishte kushtetutshëmrisht e pranueshme që ai të gjendej i detyruar nga zgjedhja e tij edhe ndaj veprave penale të reja (të ndryshme) që mund t’i ngarkoheshin”.*

25. Legjislacioni italian, ku gjendet shprehimisht i sanksionuar instituti i gjykimit të shkurtuar, si gjykim “në gjendjen që janë aktet”, fillimisht përjashtonte absolutisht aplikimin e institutit të modifikimit të akuzës¹. Zgjedhja legislative në fjalë është quajtur koherente me strukturën dhe qëllimet e këtij gjykimi nga Gjykata Kushtetuese Italiane në vendimin nr. 378/1997, pasi *“Përjashtimi i përgjigjet një funksioni garancie për të pandehurin, si dhe një logjike shpërblyese. I pandehuri pranonte të gjykohej në gjendjen që janë aktet e mbledhura nga hetimet paraprake duke ju referuar ekskluzivisht akuzës së bërë nga prokurori, që përcakton limitet e heqjes dorë të tij nga formimi i provës në kontradiktoritet, pasi në rast akuzash për vepra penale të ndryshme, konkurruese ose rrethanash rënduese, ai do të gjendej në pamundësinë për t’u mbrojtur nga zgjerimi i akuzës duke kërkuar pranimin e provave që e shfaqësojnë”.*

26. Në përfundim të analizës së këtij instituti, në rastin objekt shqyrtimi, Gjykata Kushtetuese, duke u bazuar në vlerësimet e lartpërmendura, vëren se kërkuesi duke marrë në konsideratë kualifikimin e veprës penale të “moskallëzimit të krimit”, të kryer nga prokurori, si dhe duke vlerësuar dënimin e parashikuar për këtë vepër penale (në rast të deklarimit fajtor të tij nga gjykata), ka kërkuar të procedohet me gjykim të shkurtuar, në gjendjen që janë aktet, në lidhje me këtë vepër penale, duke hequr dorë kështu në mënyrë të vullnetshme nga disa të drejta kushtetuese (marrjes së provave në kontradiktoritet, etj.) në gjykim në mënyrë që të përfitojë nga avantazhet (ulja e dënimit) e përcaktuara nga legjislatori për këtë qëllim; ndërsa gjykatat e juridiksionit të zakonshëm edhe pse kanë pranuar kërkesën e kërkuesit për të proceduar me gjykim të shkurtuar në lidhje me veprën penale të “moskallëzimit të krimit”, e kanë deklaruar fajtor dhe dënuar për një vepër penale të re, më të rëndë, atë të “trafikimit të narkotikëve” duke i cenuar kështu kërkuesit të drejtën e mbrojtjes në lidhje me veprën për të cilën është deklaruar fajtor.

C. Në lidhje me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale

27. Gjykata Kushtetuese vlerëson se, në rastin objekt shqyrtimi, instituti tjetër që duhet të shqyrtohet për t’u dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të palëve është ai i ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se ky institut mund të aplikohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, gjatë gjykimit të zakonshëm, vetëm kur zbatohen në mënyrë rigorozë kërkesat e përcaktuara nga vetë Gjykata, në mënyrë të veçantë në lidhje me garantimin e realizimit të së drejtës së mbrojtjes të palëve në gjykim ndaj formulimit të ri të veprës penale. *“Zbatimi në këtë mënyrë i kërkesave të nenit 375 të KPP-së, është një garanci për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, duke e vënë gjykatën në rolin që i takon për dhënien e drejtësisë” (shih vendimin nr.50, datë 30.7.1999 të Gjykatës Kushtetuese).*

28. Po ashtu, në lidhje me institutin në shqyrtim, GJEDNJ-ja është shprehur se *“dispozitat e paragrafit 3 të nenit 6 sanksionojnë nevojën që t’i jepet një kujdes i veçantë njoftimit të “akuzës” të interesuarit. Duke qenë se akt-akuza ka një rol të rëndësishëm në procedimin penal, neni 6, paragrafi 3 i*

¹ Disiplina e gjykimit të shkurtuar në legjislacionin italian ka ndryshuar si rrjedhojë e modifikimeve të bëra me ligjin nr.479/1999 dhe me ligjin nr.144/2000. Në legjislacionin aktual italian, në ndryshim nga legjislacioni shqiptar, gjyqtari kur çmon se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, vendos të marrë, edhe kryesisht, prova të reja të nevojshme për vendimin. Në këtë rast prokurori mund të ndryshojë akuzën dhe i pandehuri mund të kërkojë që procedimi të vazhdojë në format e zakonshme (neni 441-bis KPP Italiane). Ndërsa në rastin kur gjyqtari çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, sipas nenit 441, paragrafi i parë, të KPP-së italiane, në gjykimin e shkurtuar zbatohen dispozitat e parashikuara nga ky Kod për seancën paraprake, duke përjashtuar institutin e marrjes së provave të reja nga gjyqtari dhe atë të modifikimit të akuzës.

njeh të pandehurit të drejtën që të informohet jo vetëm me motivin e akuzës, pra me faktet materiale që i atribuohen dhe mbi të cilat bazohet akuzë, por edhe, dhe në mënyrë të detajuar, me kualifikimin juridik të dhënë këtyre fakteve (shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Pélissier dhe Sassi kundër Francës, nr. 25444/94, § 51) dhe se "... një informacion i saktë dhe i plotë i akuzave në ngarkim të një të pandehuri pra dhe i kualifikimit juridik të veprës penale që autoritetet mund të konsiderojnë në ngarkim të tij, është një kusht i rëndësishëm për procesin e rregullt ligjor" (shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Drassich kundër Italisë, kërkesa nr. 25575/04).

29. Në vijim të vlerësimeve të saj, GJEDNJ-ja institutin në fjalë e ka shqyrtuar në funksion të garantimit të së drejtës së mbrojtjes të të akuzuarit. Ajo ka theksuar se *"e drejta të informohesh për natyrën dhe motivet e akuzës duhet të konsiderohet në këndvështrimin e të drejtës të të pandehurit të përgatitë mbrojtjen e tij. Nëse gjyqtarët e themelit disponojnë, kur kjo e drejtë i është njohur në të drejtën e brendshme, mundësinë për të rikualifikuar faktet, ata duhet të sigurohen që të pandehurit kanë pasur oportunitetin të ushtrojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes në mënyrë korrekte dhe efektive. Kjo do të thotë që të pandehurit duhet të informohen në kohë të përshtatshme jo vetëm me motivet e akuzës, pra me faktet materiale që i atribuohen dhe mbi të cilat bazohet akuzë, por edhe, dhe në mënyrë të detajuar, me kualifikimin juridik të dhënë këtyre fakteve"* (shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Drassich kundër Italisë, kërkesa nr. 25575/04).

30. Bazuar në këto vlerësime, Gjykata Kushtetuese vëren se, në rastin objekt shqyrtimi, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda duke bërë ndryshimin e cilësimit të veprës penale, pasi ka pranuar kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të shkurtuar, nuk ka respektuar kërkesat e përcaktuara nga jurisprudenca shqiptare dhe ajo e GJEDNJ-së në lidhje me këtë institut. Pra, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda nuk i ka dhënë mundësinë kërkuarit për të ushtruar të drejtën e mbrojtjes ndaj veprës së re penale (për më tepër më të rëndë).

31. Në këtë këndvështrim, Gjykata Kushtetuese rithekson qëndrimin e saj se ndonëse, gjatë gjykimit të zakonshëm, është kompetencë ekskluzive e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të bëjnë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, në gjykimet e posaçme, siç konsiderohet dhe gjykimi i shkurtuar, kjo e drejtë duhet të ushtrohet në përputhje me veçoritë e këtij gjykimi e, në veçanti, me faktin se për të proceduar me këtë lloj gjykimi, përveç kërkesës së të pandehurit kërkohet detyrimisht edhe vendimi/miratimi i gjyqtarit (*shih paragrafin 18 të këtij vendimi*). E thënë ndryshe, gjyqtari në momentin e marrjes së vendimit, në lidhje me pranimin ose jo të kërkesës për gjykim të shkurtuar të të pandehurit, duhet të udhëhiqet jo vetëm nga parimi i ekonomisë gjyqësore (*shih paragrafin 19 të këtij vendimi*), por duhet të vendosë, kryesisht, në përputhje me parimin e drejtësisë efektive. Kjo do të thotë që ai, ndër të tjera, duhet të marrë në konsideratë edhe cilësimin juridik të veprës penale të përcaktuar nga prokurori. Si pasojë, nëse ka dyshime mbi këtë cilësim, ky element mjafton që gjyqtari të rrëzojë kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të posaçëm dhe të vazhdojë gjykimin me procedurën e zakonshme duke respektuar kështu të gjitha parimet e procesit të rregullt ligjor, si kontradiktoriteti, e drejta e mbrojtjes, etj.

32. Nisur nga kjo premisë, në përfundim të analizës së këtyre dy instituteve, Gjykata Kushtetuese çmon se nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm edhe në rastin kur procedohet me gjykim të shkurtuar, njësoj si në gjykimin e zakonshëm, do të mund të bëjnë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale dhe të dënojnë të pandehurin me një masë dënimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori, instituti do të humbiste çfarëdolloj justifikimi kushtetues, për arsye se i pandehuri, duke hequr dorë në mënyrë të vullnetshme nga disa parime kushtetuese, si parimi i barazisë së armëve dhe nga parimi i kontradiktoritetit, do të sakrifikohe të drejtat e tij kushtetuese jo vetëm pa pasur asnjë lloj përfitimi, por edhe duke marrë një dënim më të lartë nga ai që priste.

33. Nga sa më lart, Gjykata arrin në konkluzionin se, kur nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm procedohet me gjykim të shkurtuar, procedim në të cilin, duke qenë se gjykata merr në konsideratë vetëm dosjen e prokurorit, nuk ekziston mundësia e realizimit të së drejtës së mbrojtjes efektive nga i pandehuri, ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale nga ana e gjykatës, është në kundërshtim me qëllimin e këtij gjykimi.



34. Duke iu rikthyer çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese çmon se kërkuesi, edhe pse është proceduar me gjykim të shkurtuar, është dënuar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për një veprë penale të re, më të rëndë nga ajo e përcaktuar nga prokurori në kërkesën për gjykim, pa pasur mundësinë për të ushtruar të drejtën e mbrojtjes ndaj formulimit të ri të veprës penale.

35. Si përfundim, në vijim të arsytimit të mësipërm, Gjykata Kushtetuese vlerëson se në procesin e zhvilluar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është cenuar e drejta e kërkuetit për t'u mbrojtur në procesin penal, si një nga elementet thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f" dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
 - Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.72, datë 4.12.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë; vendimit nr.14, datë 15.2.2010 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë; vendimit nr.00-2010-1356 (971), datë 8.11.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).
 - Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Ploçi, Admir Thanza, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi.

Anëtarë kundër: Xhezair Zaganjori, Vitore Tusha.

MENDIM PAKICE

1. Jam kundër vendimit të shumicës për pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë, për këto arsye:

2. Shumica ka arritur në përfundimin se: "Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale nga ana e gjykatës së shkallës së parë, gjatë procedimit me gjykim të shkurtuar ka cenuar të drejtën e kërkuetit për t'u mbrojtur ndaj formulimit të ri të veprës penale, garantuar nga nenet 31, pika "b", e 42 të Kushtetutës".

3. Në thelb, arsytimin e saj shumica e ka mbështetur në faktin se ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale është kompetencë ekskluzive e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, gjatë gjykimit të zakonshëm, ndërsa në gjykimin e shkurtuar, kjo kompetencë nuk mund të ushtrohet për shkak të veçorive të këtij gjykimi (shih § 31 dhe 33 të vendimit). Kjo edhe për arsyen se për gjykimet e posaçme, siç konsiderohet dhe gjykimi i shkurtuar, legjislatori ka parashikuar rregulla të veçanta në kreun IV të titullit VII të KPP-së (nenet 403-406), të cilave gjyqtarët duhet t'u përmbahen gjatë zbatimit të këtij gjykimi të posaçëm dhe se përdorimi i rregullave të përgjithshme të gjykimit të zakonshëm në gjykimin e posaçëm bëhet, në mënyrë taksative, vetëm në rastet kur këtyre rregullave u referohen në mënyrë eksplicite dispozitat e veçanta të gjykimit të shkurtuar si p.sh. ai i nenit 406/4 të KPP-së në dispozitat e kreut III të titullit VII të këtij kodi (shih § 20).

4. Nuk jam dakord në lidhje me argumentet mbi të cilat shumica ka vlerësuar “moskompetencën e gjykatës së zakonshme për të ndryshuar kualifikimin e veprës penale në procedimin me gjykim të shkurtuar” si për sa i takon interpretimit të kreut IV të titullit VII të KPP-së (nenet 403-406) që përcakton rregullat e gjykimit të shkurtuar, ashtu dhe veçorive të këtij gjykimi, për arsye të cilat do t'i trajtoj në vijim.

5. Në raport me arsyetimin e shumicës, e cila ka vlerësuar se “*përdorimi i rregullave të përgjithshme të gjykimit të zakonshëm në gjykimin e posaçëm bëhet në mënyrë taksative vetëm në rastet kur këtyre rregullave u referohen në mënyrë eksplicite dispozitat e veçanta të gjykimit të shkurtuar*” (shih § 20), mendoj se rregullat e përgjithshme të gjykimit të zakonshëm në procesin penal, duhet të zbatohen gjatë gjykimit të shkurtuar për ato aspekte që nuk janë të rregulluara nga nenet 403-406 të KPP-së, për aq sa janë të pajtueshme me këto të fundit.

6. Ky arsyetim është rrjedhojë e kuptimit të drejtë e të saktë të përmbajtjes së gjykimit të shkurtuar dhe rregullave të tij. Nëse do të pranoja arsyetimin e shumicës, do të thotë të pranoja që gjyqtarët në procedurën e gjykimit të shkurtuar duhet të zbatojnë vetëm dispozitat e posaçme, nenet 403-406 dhe 379-399 të KPP-së, të referuara në mënyrë eksplicite nga neni 406/4 i KPP-së, që janë të vetmet norma të referuara në mënyrë të shprehur.

7. Normat e posaçme, përfshi këtu dhe normat e referuara, jo vetëm nuk parashikojnë asnjë ndalim të shprehur për të zbatuar norma të tjera të KPP-së, por nuk parashikojnë as detyrim për gjykatën, që në dhënien e vendimit, t'u referohet vetëm neneve të gjykimit të posaçëm. Pikërisht, për këtë arsye, në nenin 406/4 të KPP-së përcaktohet se: “*Respektohet për aq sa janë të pajtueshme dispozitat e kreut III të këtij titulli*”.

8. Neni 406/4 i KPP-së është normë referuese, lejuese dhe jo veçuese apo ndaluese. Kjo do të thotë se për vetë natyrën e veçantë që ka gjykimi i shkurtuar, mund të aplikohen nenet 379 deri 399 të KPP-së, por jo domosdoshmërisht të gjitha këto dispozita, si p.sh. neni 380, që bën fjalë për provat që mund të përdoren për të marrë vendimin, pasi kjo dispozitë e kushtëzon gjykatën që të përdorë vetëm provat e verifikuara në shqyrtimin gjyqësor. Në gjykimin e shkurtuar, shqyrtimi gjyqësor, ose më saktë pjesa kryesore e shqyrtimit gjyqësor, siç është debati gjyqësor që palët ndërgjyqëse bëjnë lidhur me provat e kërkuara prej tyre, nuk lejohet, pasi vetë palët kanë preferuar që të heqin dorë nga ky debat. Nisur edhe nga formulimi i nenit 406/4 të KPP-së, që përcakton në mënyrë të shprehur “*...për aq sa janë të pajtueshme...*”, zbatuesit dhe interpretuesit e kësaj norme duhet ta vlerësojnë atë si lejuese dhe jo veçuese apo ndaluese për të zbatuar dispozitat e tjera të këtij Kodi.

9. Një aspekt tjetër që rezulton nga interpretimi i neneve 406/4, 375, 382 dhe 383 të KPP-së është se zbatimi i nenit 375 të KPP-së është i parashikuar në mënyrë të shprehur (ndryshe nga sa arsyeton shumica) edhe kur gjykimi është i shkurtuar. Siç parashitrova më sipër, referimi që bën neni 406/4 i KPP-së te normat e kreut III të titullit VII (nenet 379-399, KPP), do të thotë që për aq sa janë të pajtueshme, këto të fundit respektohen nga gjykata. Të gjitha këto norma përmbajnë rregulla në lidhje me dhënien e vendimit përfundimtar. Po ashtu, edhe përcaktimi që bën neni 375 (ndryshimi i cilësimit juridik të veprës) i KPP-së, se: “*Me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori ose i dëmtuari akuzues, më të lehtë ose më të rëndë, me kusht që vepra penale te jetë në kompetencën e saj*”, sjell përfundimin pa asnjë mëdyshje, qartazi, se akti procedural përmes të cilit ushtrohet kompetenca për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, është vendimi përfundimtar. Në këtë kuptim, neni 375 i KPP-së është pjesë përbërëse e normave mbi të cilat merret vendimi përfundimtar (nenet 379-399 të KPP-së) të cilat referon në mënyrë të shprehur neni 406/4 i KPP-së.

10. Po ashtu mendoj se normat që parashikon KPP-ja për gjykimin e shkurtuar parashikojnë ato rregulla që janë të veçanta e që duhen zbatuar nga gjykata gjatë kësaj procedure. Megjithatë, kjo s'do të thotë që janë të vetmet rregulla të lejueshme për t'u aplikuar në gjykimin e shkurtuar.

11. Interpretimi i shumicës e imponon gjykatën që në gjykime penale me procedurë të shkurtuar t'i referohet një grupi të kufizuar normash procedurale, që do të thotë t'i heqësh gjykatës së zakonshme detyrimin ligjor e kushtetues, për t'u udhëhequr edhe në gjykimin e posaçëm nga parimet e përgjithshme procedurale. Do të thotë të krijosh pengesa, boshllëk ligjor për gjykatën e zakonshme në ushtrimin e



funksionit të saj të vetëm, që është “dhënia e drejtësisë” (sanksionuar në nenet 2, 3, 11 dhe 12 të KPP-së) në mënyrë të plotë dhe efikase, pavarësisht nga procedura e ndjekur në gjykim.

12. Të vlerësosh si të pazbatueshme në gjykimin e shkurtuar, rregullat e përgjithshme të gjykimit të zakonshëm do të thotë t’i heqësh mundësinë të gjykuarve/ të pandehurve, të parashtrojnë kërkesa në zbatim të neneve 15-23 të KPP-së, lidhur me papajtueshmërinë e gjyqtarit që gjykon çështjen dhe që garanton gjykimin nga një gjykatë e paanshme.

13. Si konkluzion, mendoj se neni 375 i KPP-së, që përcakton kualifikimin ligjor të veprës penale, nuk është i përjashtuar nga zbatueshmëria gjatë vendimmarrjes së gjykatës në një gjykim të zhvilluar me procedurë të shkurtuar.

14. Ndaj mendim të ndryshëm edhe lidhur me rolin që luajnë veçoritë e gjykimit të shkurtuar në garantimin e të drejtës së mbrojtjes, si element thelbësor i procesit të rregullt ligjor.

15. Shumica e ka vlerësuar gjykimin e shkurtuar si proces, i cili karakterizohet nga heqja dorë në mënyrë të vullnetshme nga i pandehuri nga e drejta e mbrojtjes, si dhe nga parimi i kontradiktoritetit (shih § 20); nga heqja dorë nga marrja e provave në kontradiktoritet (shih § 26). Po ashtu, duke arsyetuar se “gjykata në këtë gjykim merr në konsideratë vetëm dosjen e prokurorit”, shumica ka vlerësuar se “nuk ekziston mundësia e realizimit të së drejtës së mbrojtjes efektive nga i pandehuri” dhe, për këtë shkak “ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale nga ana e gjykatës është në kundërshtim me qëllimin e këtij gjykimi” (shih §33).

16. E drejta për një proces të rregullt ligjor, si një nga të drejtat themelore, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës si dhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), i garanton individit, që gjykohet në procedurë të zakonshme penale, apo të shkurtuar, të drejtën për t’u gjykuar në një proces gjyqësor që zbaton, krahas parimeve të tjera, edhe parimin e kontradiktoritetit, të barazisë së armëve, të drejtën për t’u mbrojtur, etj.

17. Në gjykimin e shkurtuar i pandehuri nuk ndalohej të heqë dorë nga disa të drejta, të përkufizuara si standarde të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Kjo veçori e gjykimit të shkurtuar është trajtuar edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila ka theksuar se: “*as teksti, dhe as fryma e nenit 6 të Konventës nuk ndalojnë që një person të heqë dorë në mënyrë spontane dhe të shprehur nga kjo e drejtë. Por, që të merret në konsideratë nën këndvështrimin e Konventës, kjo heqje dorë duhet të jetë e shprehur në mënyrë eksplicite dhe duhet të jetë e shoqëruar me një minimum garancish*”(shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Scoppola kundër Italisë, kërkesa nr. 10249/03).

18. Në lidhje me procedurat që mund të reduktohen në gjykimin e shkurtuar, GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Procedura gjatë gjykimit të shkurtuar është e shoqëruar me një lehtësim të garancive procedurale të ofruara nga e drejta e brendshme, në veçanti për sa i përket publicitetit të diskutimit, si dhe mundësisë që të kërkohet paraqitja e provave dhe thirrja e dëshmitarëve*” (shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Kwiatkowska kundër Italisë, nr. 52868/99).

19. Në lidhje me avantazhet që krijon për të pandehurin gjykimi i shkurtuar, GJEDNJ-ja ka çmuar se: “*Kur procedura e gjykimit të shkurtuar ekziston dhe aplikohet, parimet e procesit të rregullt ligjor imponojnë që të mos privohet në mënyrë arbitrare i pandehuri nga avantazhet që lidhen me atë procedurë dhe që i garantohen nga legjislacioni i brendshëm* (shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Scoppola kundër Italisë, kërkesa nr. 10249/03).

20. Në vështrim të sa më sipër, e veçanta e gjykimit të shkurtuar konsiston në procedurat më të thjeshtuara dhe më të reduktuara, përmes të cilave zbatohen elementët e procesit të rregullt, që do të thotë se i pandehuri lejohet në kuptimin kushtetues dhe të KEDNJ-së të heqë dorë nga disa të drejta si për sa i takon seancës publike, thirrjes së dëshmitarëve në gjykim, apo të paraqesë provat të tjera tej atyre të marra gjatë hetimeve paraprake.

21. Mendoj se heqja dorë në mënyrë eksplicite nga e drejta e mësipërme nuk mund të kuptohet si heqje dorë tërësisht nga parimi i kontradiktoritetit dhe i barazisë së armëve. Vullneti i shprehur i të pandehurit për të pranuar aktet në gjendjen që janë, si parakusht i zbatimit të këtij gjykimi, është një kërkesë e nenit 403 të KPP-së, kërkesë kjo sa formale, aq dhe substanciale. Në thelb, kërkesa për gjykim të shkurtuar shpreh, nga njëra anë, vullnetin e të pandehurit për të hequr dorë nga e drejta për seancë

publike, nga thirrja e dëshmitarëve në gjykim dhe nga paraqitja e provave dhe, nga ana tjetër, nënkupton që të pandehurit nuk i mohohet e drejta për të kundërshtuar provat e paraqitura nga organi i akuzës, përmes kërkesës për pavlefshmëri ashtu dhe për papërdorshmërinë e këtyre provave, qoftë dhe në diskutimin përfundimtar. Po kështu, e drejta e të pandehurit për të parashtruar konkluzionin përfundimtar, në zbatim të nenit 405/5 të KPP-së, ndryshe nga sa argumenton shumica (shih § 26), përfshin edhe të drejtën e tij për të kundërshtuar akuzën me të cilën po gjykohet. Kjo procedurë reflekton kontradiktoritetin në gjykimin e shkurtuar, pasi gjykata nuk gjykon vetëm mbi dosjen e prokurorit, siç vlerëson shumica (shih § 33).

22. Në përfundim të këtij arsytimi mendoj se heqja dorë e të pandehurit nga të drejtat e tij për seancë publike, për thirrje të dëshmitarëve në gjykim apo për paraqitje të provave të tjera, që janë disa nga elementet që lehtësojnë, thjeshtojnë apo reduktojnë kontradiktoritetin e procesit gjyqësor, nuk e zhvesh gjykimin e shkurtuar nga kontradiktoriteti. Jo vetëm kaq, por kontradiktoriteti i reduktuar i procedurës së gjykimit të shkurtuar, që i lejon apo mundëson të pandehurit një alternativë ndryshe të gjykimit të tij penal, duhet parë si konkretizim i mbrojtjes së zgjedhur nga i pandehuri. Në këtë këndvështrim, mendoj se rregullat e gjykimit të shkurtuar, nuk sjellin kufizim apo cenim në drejtim të garantimit të të drejtës së mbrojtjes, por përkundrazi kjo procedurë në vetvete pasqyron strategjinë e mbrojtjes së të pandehurit që gjykohet me këtë procedurë.

23. Kompetenca e gjykatës për të ndryshuar kualifikimin ligjor të veprës penale, në përputhje me nenin 375 të KPP-së, vlerësoj se nuk ndikohet nga lloji i procedurës së gjykimit të çështjes, gjykim i zakonshëm apo i shkurtuar. Të pranosh të kundërtën do të thotë të konsiderosh kualifikimin e bërë nga prokurori si një avantazh të kësaj procedure. Në të vërtetë, avantazhi i vetëm që i garantohet të pandehurit në rastet kur gjykata jep vendim dënimi, është zbritja me 1/3 e dënimit. Pikërisht, ky përcaktim ligjor duhet të garantohet nga gjykata, pasi në të kundërt procesi do të ishte i parregullt.

24. Nëse gjykata vlerëson se çështja mund të gjykohet në gjendjen që janë aktet, por refuzon kërkesën e të pandehurit për gjykim të shkurtuar për shkak të dyshimeve për kualifikimin ligjor që akuza i ka bërë faktit të ndodhur (shih § 31), atëherë refuzimi vetëm për shkakun e mësipërm do të sjellë si pasojë vënien në dyshim të paanësisë objektive të gjykatës dhe mospërfitimin nga i pandehuri të zbritjes së dënimit në masën e përcaktuar nga ligji, edhe në rast rikualifikimi të veprës penale në vendimin përfundimtar. Ky arsytim nuk është në funksion të drejtësisë efektive, por në fakt cenon të drejtën e të pandehurit për të përfitur nga procedura sipas kushteve të përcaktuara në ligj, e thënë ndryshe i cenon atij të drejtën e mbrojtjes.

25. GJEDNJ-ja ka vlerësuar kompetencën e gjykatës së themelit që të rikualifikojë faktet lidhur me garantimin e mundësisë që ka i pandehuri për të ushtruar të drejtën e mbrojtjes. Në këtë drejtim ajo shprehet se: *“Nëse gjyqtarët e themelit disponojnë, kur kjo e drejtë i është njohur në të drejtën e brendshme, mundësinë për të rikualifikuar faktet, ata duhet të sigurohen që të pandehurit kanë pasur oportunitetin të ushtrojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes në mënyrë korrekte dhe efektive* (shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Drassich kundër Italisë, kërkesa nr. 25575/04).

26. Në çështjen konkrete, për të arritur në përfundime mbi respektimin apo jo të së drejtës së mbrojtjes në këtë proces, duhet vlerësuar edhe nëse kërkuesi ka pasur ose jo mundësi për të debatuar në një procedurë kontradiktore veprën penale me të cilën gjykata e shkallës së parë e kishte dënuar pas një kualifikimi të ndryshëm nga ai akuzës, mbi të cilin është deklaruar fajtor dhe dënuar.

27. Legjislacioni ynë procedural (neni 406/3 i KPP-së) lejon dhe mundëson të drejtën e të pandehurit për t’u ankuar ndaj vendimit përfundimtar të gjykatës (përfshi dhe rikualifikimin) të dhënë në një gjykim të shkurtuar si në gjykatën e apelit, ashtu edhe në Gjykatën e Lartë (neni 432 i KPP-së). Po ashtu, neni 441, pika 1, shkronja “b” i KPP-së lejon rikualifikimin ligjor të veprës penale edhe në Gjykatën e Lartë, e cila urdhëron kthimin e akteve për rishqyrtim, bazuar në nenin 443 të KPP-së. Pra, edhe ligji ynë procedural i ka hapësirat e nevojshme për të respektuar të gjitha të drejtat e palëve në proces, sidomos ato të të akuzuarit, duke i dhënë mundësinë këtij të fundit të mbrohet lidhur me cilësimin e ri juridik të veprës penale.

28. Në rastin konkret, kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në Gjykatën e Apelit dhe po ashtu ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Në thelb, ai



ka kundërshtuar rikualifikimin ligjor që gjykata i ka bërë veprës penale. Pra, i dënuari, me ndihmën e mbrojtësit të zgjedhur prej tij, siç ka pohuar dhe vetë para Gjykatës Kushtetuese, i ka përdorur të gjitha mjetet juridike penale për të mbrojtur të drejtat e tij.

29. Shumica arsyeton se ndryshimi i kualifikimit nuk mund të bëhet në gjykimin e shkurtuar në shkallë të parë, duke mos vlerësuar nëse i pandehuri e ka pasur mundësinë të ushtrojë të drejtën e ankimit për të garantuar mbrojtjen ndaj kualifikimit të ri ligjor. Është me rëndësi të theksohet se vendimi i GJEDNJ-së në çështjen Drassich kundër Italisë, ka trajtuar një situatë krejtësisht të ndryshme nga rasti në shqyrtim, pasi rikualifikimi i veprës penale është bërë për herë të parë në Gjykatën e Kasacionit. Vlerësoj se ky vendim duhej t'i shërbente shumicës si referencë për standarde që lidhen me fakte tërësisht të ngjashme dhe jo për kontekste të ndryshme, siç është edhe rasti objekt shqyrtimi.

30. Vendimi i mësipërm i GJEDNJ-së, që ka konstatuar shkelje në të drejtën e mbrojtjes së aplikantit, shprehet: *“Gjykata konstaton në tërësi se rikualifikimi i kundërshtuar ka ndodhur në momentin e gjyimit të çështjes në Gjykatën e Kasacionit në dhënien e vendimit prej saj. Për më tepër, nuk rezulton që prokurori ose ndonjë nga gjyqtarët në përbërje të trupit gjykues të një juridiksioni të lartë të kenë ngritur mundësinë për ricilësimin e fakteve të çështjes në një shkallë të mëparshme të procedimit. Në këto kushte, nuk është vendosur apo përcaktuar që kërkuesi të jetë paralajmëruar për mundësinë e një rikualifikimi të akuzës së ngritur ndaj tij, dhe aq më pak që ai të ketë pasur mundësinë të debatohet në një procedure kontradiktore akuzën e re”* (shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Drassich kundër Italisë, kërkesa nr. 25575/04 paragrafi 36).

31. Përfundimisht, mendoj se rikualifikimi juridik i veprës penale mund të bëhet nga gjykata me vendimin përfundimtar, si në gjykimin e zakonshëm, ashtu dhe në atë të shkurtuar, pasi nuk cenon të drejtën e kërkuesit për t'u mbrojtur në procesin penal. Nga sa më lart, jam e mendimit se ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale gjatë procedimit me gjykim të shkurtuar nuk ka cenuar të drejtën e kërkuesit për një proces të rregullt ligjor.

Anëtare: Vitore Tusha.

VENDIM Nr.5, datë 16.2.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Pllaçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha,	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi ¹	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Altina Xhoxhaj	Anëtare e “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “

me sekretare Enina Mullaj, në datë 15.6.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 21/4 Akti, që i përket:

KËRKUES: Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, përfaqësuar nga Ervin Metalla dhe Julian Haxhiu, me autorizim.

¹ Gjyqtari Sokol Sadushi ka marrë pjesë në seancë, por jo në votim për arsye të mbarimit të mandatit dhe zëvendësimit të tij.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj dhe Arjeta Çefa, me autorizim.

Këshilli i Ministrave, Ministria e Drejtësisë, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.
Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtuëshëm me Kushtetutën, i fjalisë “Në këtë rast gjyqtari mund të transferohet edhe në institucionet e parashikuara në nenin 28/1 të këtij ligji, duke përfituar pagesën e gjyqtarit”, si dhe i shprehjes “ose më të ulët” të nenit 42/1 të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

BAZA LIGJORE: Nenet 7, 138, e 147/5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberin, përfaqësuesin e kërkuarit që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Drejtësisë, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (Kuvendi), në datën 18.2.2008, ka miratuar ligjin nr.9877 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (*këtu e në vijim referuar si ligji nr.9877/2008*). Në nenin 42/1 të këtij ligji thuhet se: “Pavarësisht nga pika 1 e nenit 21 të këtij ligji, kur një gjykatë mbyllet ose numri i gjyqtarëve zvogëlohet, për shkak të riorganizimit gjyqësor, gjyqtari mund të transferohet në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel ose më të ulët. Në këtë rast gjyqtari mund të transferohet edhe në një nga institucionet e parashikuara në nenin 28/1 të këtij ligji, duke përfituar pagën e gjyqtarit”.

2. Kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar se fjalia “Në këtë rast gjyqtari mund të transferohet edhe në institucionet e parashikuara në nenin 28/1 të këtij ligji, duke përfituar pagesën e gjyqtarit”, si dhe shprehja “ose më të ulët” të nenit 42/1 të ligjit nr.9877/2008 duhet të shfuqizohet, pasi bien në kundërshtim me nenet 7, 138 dhe 147/5 të Kushtetutës.

3. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar këto argumente:

3.1 Si një element mbrojtës i pavarësisë së pushtetit gjyqësor, palëvizshmëria e gjyqtarit garantohej nëpërmjet përcaktimeve të sakta të mbarimit të funksionit të gjyqtarit, si edhe nëpërmjet kufizimit në mënyrë taksative të rasteve të transferimit të gjyqtarëve. Në nenin 147/5 të Kushtetutës është përcaktuar se: “Transferimi i gjyqtarëve nuk mund të bëhet pa pëlqimin e tyre, përveç kur këtë e diktojnë nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor”;

3.2 Fjalia “Në këtë rast gjyqtari mund të transferohet edhe në institucionet e parashikuara në nenin 28/1 të këtij ligji, duke përfituar pagesën e gjyqtarit”, në nenin 42/1 të ligjit nr. 9877/2008 nënkupton se, gjyqtari transferohet pa pëlqimin e tij në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmës ligjor ose këshilltar i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të gjykatës së apelit, prokuror, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Ky formulim i ligjit bie ndesh me nenin 7 dhe nenin 147/5 të Kushtetutës. Parimi i ndarjes së pushteteve do ta humbiste kuptimin e tij në rast të lejimit të transferimit të njerëzve që punojnë në njërin pushtet tek tjetri.

3.3 Gjyqtari i transferuar në institucionet jashtë pushtetit gjyqësor mund të bëhet objekt i masave disiplinore të cilat janë në ekskluzivitet të titullarit të institucionit. Për rrjedhojë, cenohet garantimi i palëvizshmërisë së gjyqtarit.

3.4 Përcaktimi i dhënë në nenin 42/1 të ligjit nr. 9877/2008, për transferimin e gjyqtarit në një gjykatë më të ulët, sjell automatikisht uljen në detyrë, karrierë dhe pagë të gjyqtarit që emërohet në një gjykatë më të ulët. Paprekshmëria e pagës së gjyqtarit është përcaktuar në nenin 138 të Kushtetutës, ku thuhet: “Koha e qëndrimit të gjyqtarit në detyrë nuk mund të kufizohet, paga dhe përfitimet e tjera në



detyrë nuk mund të ulen”. Kështu që transferimi i gjyqtarit në një gjykatë më të ulët, në rast të riorganizimit të pushtetit gjyqësor, nuk e përmbush kriterin e ligjshmërisë të përcaktuar në nenin 147/5 të Kushtetutës.

3.5 Në pikën 3.4 të Kartës Evropiane mbi Statusin e Gjyqtarëve është përcaktuar se: “Një gjyqtar/e që ushtron këtë funksion nuk mund, në parim, të caktohet në një pozitë gjyqësore tjetër ose të caktohet diku tjetër, madje as nëpërmjet ngritjes në pozitë, pa dhënë lirisht pëlqimin e tij/saj. Përrjashtim nga ky parim, lejohet vetëm në rastin kur transferimi parashikohet dhe është shprehur si sanksion disiplinor, në rastin e një ndryshimi të ligjshëm të sistemit gjyqësor dhe në rastin e një caktimi të përkohshëm për të përforcuar një gjykatë fqinje, me kohëzgjatje maksimale të këtij caktimi të kufizuar rigorozisht me ligj”.

4. Subjekti i interesuar, **Kuvendi**, ka kundërshtuar si vijon:

4.1 Dispozitat e ligjit objekt shqyrtimi janë në përputhje të plotë dhe në harmoni me Kushtetutën e Shqipërisë. Vetë Kushtetuta në nenin 147/5 parashikon, si rast përjashtimor, transferimin pa pëlqim të gjyqtarit, kur këtë e diktojnë nevojat e organizimit të sistemit gjyqësor.

4.2 Transferimi i gjyqtarit në institucione të tjera jashtë sistemit gjyqësor, sipas nenit 28 të ligjit nr. 9877/2008 bëhet në përputhje me një sërë garancish siç janë pëlqimi i gjyqtarit, koha e kufizuar e qëndrimit, kthimi në vendin e mëparshëm të punës dhe trajtimi financiar.

4.3 Formulimi i nenit 42/1 të ligjit nr.9877/2008 nuk cenon nenet 7 dhe 147 të Kushtetutës.

4.4 Ligji, nr.9877/2008, në funksion të nenit 147/5 të Kushtetutës, parashikon një sërë garancish për rastet kur gjyqtari transferohet jashtë sistemit gjyqësor.

4.5 Transferimi në një gjykatë më të ulët nuk cenon statusin e gjyqtarit.

5. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Drejtësisë, kanë parashtruar bashkërisht pretendimet e tyre si vijon:

5.1 Kërkuesi e ka paraqitur kërkesën jashtë afatit ligjor 3-vjeçar të përcaktuar në nenin 50 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

5.2 Kërkuesi nuk legjitimohet në lidhje me kërkimin për antikushtetutshmëri të dispozitave të nenit 42/1 të ligjit nr.9877/2008.

5.3 Nuk jemi përpara cenimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor.

5.4 Transferimi i gjyqtarit, siç parashikohet nga dispozitat që kundërshtohen, është në përputhje me Kushtetutën dhe garanton statusin e gjyqtarit.

5.5 Transferimi i gjyqtarit në një gjykatë më të ulët bëhet për një shkak të parashikuar nga Kushtetuta dhe lidhet me mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor, duke garantuar në këtë mënyrë interesin publik.

5.6 Parimi i ndarjes së pushteteve nuk cenohet nga transferimi i gjyqtarit në një nga institucionet e parashikuara në nenin 28/1 të ligjit nr. 9877/2008.

II

Për legjitimitimin e kërkuesit

6. Subjektet e interesuara, Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Ministrave, kanë ngritur pretendimin se kërkuesi nuk legjitimohet nga pikëpamja formale, për arsye të dekadencës së afatit për të paraqitur kërkesën (*ratione temporis*). Përveç kësaj, këto subjekte të interesuara pretendojnë se kërkuesi nuk legjitimohet, as në aspektin substancial (*ratione materiae*), për t’iu drejtuar Gjykatës në lidhje me kërkimin për antikushtetutshmëri të neneve përkatëse, objekt i këtij kontrolli kushtetues.

7. Çështjen e legjitimitimit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me iniciimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciues, që parashikohen në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Shoqatat, në cilësinë e “organizatave të tjera”, janë të

specifikuara në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, shoqatat paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve e interesave të përbashkëta (*shih vendimet nr. 11, datë 6.4.2010 dhe nr. 35, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Shoqatat duhet të provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin janë krijuar apo veprimtarisë që ato kryejnë dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat, që kërkojnë të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën (*shih vendimet nr.4, datë 23.2.2011; nr.9, datë 23.3.2010; nr.4, datë 12.2.2010; nr. 17, datë 25.7.2008; nr. 9, datë 19.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Gjykata është shprehur se vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të situatës së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis situatës së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, tek dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit (*shih vendimet nr. 43, datë 6.10.2011; nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 16, datë 25.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkuksi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të rregullimit të parashikuar nga neni 134, pika 1, shkronja “f” i Kushtetutës dhe neni 49, pika 2 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë është një subjekt juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.2171, datë 4.2.2008. Në statutin e Shoqatës, neni 1, parashikohet: “*Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë është një organizatë jofitimprurëse, vullnetare, e pavarur, profesionale e cila bashkon gjyqtarë shqiptarë dhe kontribuon në mbrojtjen e interesave të tyre profesionale, shoqërore, intelektuale, materiale, si dhe në forcimin e një imazhi publik pozitiv për gjykatat shqiptare*”. Siç rezulton edhe nga vendimi për regjistrimin si person juridik, anëtarët e shoqatës janë gjyqtarë të të gjitha shkallëve të gjyqësorit të juridiksionit të zakonshëm. Neni 8 i statudit, parashikon se “*...duke bashkuar gjyqtarët, shoqata ka për qëllim të ndihmojë në mbrojtjen e interesave të tyre ...; të forcojë pavarësinë e pushtetit gjyqësor, si dhe të përsosë dhe konsolidojë pozitën e balancuar të pushtetit gjyqësor në raport me pushtetin legjislativ dhe atë ekzekutiv*”. Në këto kushte, Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, pasi është krijuar si shoqatë dhe gëzon personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit.

11. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se, bazuar në statutin, aktin e themelimit dhe natyrën e veprimtarisë së shoqatës, provohet lidhja e drejtpërdrejtë midis veprimtarisë ligjore për të cilën ajo është krijuar dhe çështjes kushtetuese të pretenduar prej saj. Në këto rrethana, Gjykata çmon se kërkuksi legjitimohet për vënien në lëvizje të Gjykatës në funksion të kontrollit kushtetues të dispozitave ligjore, objekt shqyrtimi. Edhe për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, Gjykata konstaton se kërkuksi e ka paraqitur kërkesën në përputhje me afatet kohore të përcaktuara në nenin 50 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

12. Për rrjedhojë, pretendimi i përfaqësuesve të subjekteve të interesuara, Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Ministrave, në lidhje me legjitimitimin e kërkuksit është i pabazuar.

III

A. Për pretendimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të fjalisë “Në këtë rast gjyqtari mund të transferohet edhe në institucionet e parashikuara në nenin 28/1 të këtij ligji, duke përfutuar pagesën e gjyqtarit”, në nenin 42/1 të ligjit nr. 9877/2008

13. Kërkuksi pretendon se fjalia “Në këtë rast gjyqtari mund të transferohet edhe në institucionet e parashikuara në nenin 28/1 të këtij ligji, duke përfutuar pagesën e gjyqtarit”, në nenin 42/1 të ligjit nr.9877/2008 nënkupton se gjyqtari transferohet pa pëlqimin e tij në institucionet e parashikuara nga



ligji. Kjo, sipas kërkesës, bie ndesh me parimin e palëvizshmërisë së gjyqtarit, dhe parimin e ndarjes së pushteteve, siç janë parashikuar, përkatësisht në nenin 147/5 dhe nenin 7 të Kushtetutës.

14. Neni 147/5 i Kushtetutës parashikon se: “*Transferimi i gjyqtarëve nuk mund të bëhet pa pëlqimin e tyre, përveç kur këtë e diktojnë nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor*”. Ndërsa neni 7 i Kushtetutës sanksionon se: “*Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor*”.

15. Në vështrim të nenit 7 të Kushtetutës pushteti ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor janë të ndarë, efektivisht të pavarur dhe të balancuar midis tyre. Ndonëse renditen njëri pas tjetrit, tri pushtetet e përmendur nuk qëndrojnë në varësi hierarkike nga njëri-tjetri dhe as nuk dominojnë apo i nënshtrohen ndikimeve reciproke extraligjore (*shih vendimet nr.11, datë 6.4.2010 dhe nr.19, datë 3.5.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në nenin 145/1 të Kushtetutës parashikohet se: “*Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve*”. Pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Gjykata ka theksuar se parimi i pavarësisë, i deklaruar në disa dispozita të Kushtetutës, kërkon, në radhë të parë, që gjyqtarët dhe gjykatat, ndërsa japin drejtësi, t’u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Ata duhet të jenë të paanshëm dhe objektivë në gjykimin e çështjeve (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 3.5.2007*). Gjykatat kanë të drejtën ekskluzive për funksionin e dhënies së drejtësisë. Asnjë institucion tjetër shtetëror apo zyrtar publik, përveç gjykatave të pavarura, nuk mund ta ushtrojë këtë funksion. Ky funksion i gjykatave përcakton vendin e gjyqësorit në sistemin e institucioneve të pushtetit shtetëror dhe statusin e gjyqtarëve (*shih vendimin nr.11, datë 6.4.2010 dhe nr.11, datë 2.4.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në vlerësimin e Gjykatës, pavarësia e gjyqësorit kuptohet si pavarësi *substanciale*, që do të thotë “*liri e gjykatave për të dhënë vendime, të cilat nuk bazohen në interesat e ndonjë dege tjetër të pushtetit*”; *pavarësi strukturale* që lidhet me parashikimin në Kushtetutë apo në ligj të ekzistencës së institucionit, të mënyrës së formimit të përbërjes së tij; *pavarësi organizative* që përfshin strukturimin e brendshëm administrativ të gjykatave; *pavarësi financiare* që nënkupton autonomi në hartimin e buxhetit nga vetë institucioni dhe miratimin nga legjislativi, si një zë i veçantë i buxhetit të shtetit, fonde të përshtatshme e të mjaftueshme për të realizuar qëllimin dhe detyrat e institucionit e sovranitet në lidhje me administrimin e fondeve të akorduara; si dhe *pavarësi personale*, që kërkon emërim në bazë të kriterëve objektive, imunitet, garanci ekonomike, garanci për karrierën, sistem të transferimit dhe një sistem disiplinor (*shih vendimin nr.11, datë 6.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në funksion të garantimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor duhet të jetë edhe statusi ligjor i gjyqtarëve. Garancitë kushtetuese për statusin e gjyqtarit lidhen kryesisht me emërimin, paprekshmërinë dhe palëvizshmërinë e tyre nga detyra pa shkaqe të përligjura, me mosndjekjen e tyre penalisht pa pëlqimin e KLD-së dhe disiplinarisht pa vendim të motivuar të KLD-së, si dhe me garancitë financiare. Vlerësimi i sistemit të garancive dhe pavarësia e gjyqtarëve janë ngushtësisht të ndërlidhura ndërmjet tyre (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.26, datë 24.7.2009; nr.11, datë 024.2008; nr.11, datë 27.5.2004*).

19. Sipas nenit 147/5 të Kushtetutës, transferimi i gjyqtarëve nuk mund të bëhet pa pëlqimin e tyre, përveç kur këtë e diktojnë nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor. Nisur nga ky formulim i dispozitës kushtetuese, Gjykata konstaton se konsensusi i gjyqtarit për transferimin e tij është një garanci kushtetuese në funksion të ruajtjes së principit të palëvizshmërisë së gjyqtarit. Garancitë kushtetuese që lidhen me palëvizshmërinë e gjyqtarëve, si dhe me paprekshmërinë e pagës e të përfitimeve të tjera, për shkak të funksionit, kanë ndikimin e tyre që gjyqtari të ushtrojë funksionin e tij në mënyrë të pavarur (*shih vendimin nr. 11, datë 2.4.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin konkret, rregullimi i nenit 42/1 të ligjit nr.9877/2008 parashikon, *inter alia*, se në rastet e riorganizimit të sistemit gjyqësor gjyqtari mund të transferohet edhe në institucionet e parashikuara në nenin 28/1 të ligjit duke përfutur pagën e gjyqtarit. Neni 28/1 i ligjit nr.9877/2008 parashikon se: “*gjyqtarët, me kërkesë të institucioneve e pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë,*

të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmës ligjor ose këshilltar të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës së Apelit, prokuror, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim të këtij afati gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës”.

21. Gjykata vlerëson se, në rastin në shqyrtim, mund të aplikohet një interpretim pajtues i ligjit të kundërshtuar. Ky interpretim është i mundur kur një ligj apo dispozitë ligjore mund të interpretohet në më shumë se një mënyrë, njëra nga të cilat është në pajtim me Kushtetutën. Për këtë qëllim Gjykata do të bëjë një interpretim sistematik të dispozitave ligjore të nenit 42/1 dhe nenit 28/1 të ligjit nr. 9877/2008.

22. Duke analizuar dispozitën e nenit 28/1 të ligjit nr.9877/2008, Gjykata vëren se transferimi jashtë sistemit gjyqësor, në institucionet përkatëse të parashikuara në këtë nen, bëhet me konsensusin e gjyqtarit, në respekt të standardit kushtetues të dhënies së pëlqimit, siç është përcaktuar në nenin 147/5 të Kushtetutës. Sipas nenit 42/1 të ligjit nr. 9877/2008, gjyqtari mund të transferohet jashtë sistemit gjyqësor, në institucionet e parashikuara në nenin 28/1 të po këtij ligji, edhe në rastet e riorganizimit gjyqësor, duke përfutur pagën e gjyqtarit. Nisur nga tërësia e këtyre dispozitave si dhe nga qëllimi (*ratio legis*) i ligjit 9877/2008, Gjykata vlerëson se transferimi i gjyqtarit në institucionet e parashikuara në nenin 28/1, në rastet e riorganizimit gjyqësor, bëhet me pëlqimin e tij dhe duke ruajtur pagën e gjyqtarit. Në vlerësimin e Gjykatës, dispozitat e neneve 42/1 dhe 28/1 të ligjit 9877/2008, të para në harmoni me njëra-tjetrën, respektojnë garancitë kushtetuese të dhënies së pëlqimit dhe të ruajtjes së pagës së gjyqtarit, në përputhje me dispozitat kushtetuese.

23. Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se parimi i ndarjes së pushteteve do ta humbiste kuptimin e tij në rast të lejimit të transferimit të njerëzve që punojnë në njërin pushtet tek tjetri. Gjykata në jurisprudencën e saj ka ritheksuar se parimi i ndarjes së pushteteve, i sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës, nënkupton se ligjvënësi, ekzekutivi dhe gjyqësori janë të ndarë, efektivisht të pavarur dhe me një balancë ndërmjet tyre. Çdo institucion i një pushteti gëzon kompetenca sipas këtij qëllimi. Përmbajtja konkrete e këtyre kompetencave varet nga fakti se cilit pushtet i përket ky institucion, nga vendi i tij midis institucioneve të tjera, si dhe nga raportet e fuqive të tij me ato të institucioneve të pushtetit shtetëror. Në përputhje me funksionet e ngarkuara nga Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me pushtet të mjaftueshëm, gjë që i jep mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur (*shih vendimet nr.29, datë 31.5.2010 dhe nr.25, datë 5.12.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në çështjen konkrete, Gjykata vlerëson se transferimi i gjyqtarëve në funksione jashtë sistemit gjyqësor, në kuptim të ligjit 9788/2008, bëhet në respektim të disa garancive që janë: a) dhënia e pëlqimit; b) ruajtja e pagës së gjyqtarit; c) kohëzgjatja e kufizuar e transferimit (3 vjet); dhe d) rikthimi në detyrën e mëparshme pas mbarimit të afatit 3-vjeçar. Për më tepër Gjykata e çmon transferimin e gjyqtarëve në funksione jashtë sistemit gjyqësor, në interes të administrimit të drejtësisë dhe si një pasurim të eksperiencës profesionale të gjyqtarit. Në këtë kontekst, ushtrimi nga ana e gjyqtarit i funksioneve jashtë pushtetit gjyqësor duhet të shihet si një vlerësim i kontributit profesional që vetë pushteti gjyqësor mund t'i ofrojë institucioneve shtetërore.

25. Bazuar në çka është arsyetuar më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se ligji i kundërshtuar është kushtetues, sipas interpretimit të mësipërm.

26. Si rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ligji i kundërshtuar nuk cenon nenet 7 dhe 147/5 të Kushtetutës.

B. Për pretendimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të shprehjes “ose më të ulët” të nenit 42/1 të ligjit nr. 9877/2008

27. Kërkuesi ka pretenduar se transferimi i gjyqtarit në një gjykatë më të ulët, në rast të riorganizimit të pushtetit gjyqësor, cenon nenin 138 të Kushtetutës në lidhje me paprekshmërinë e pagës dhe nuk e përmbush kriterin e ligjshmërisë të përcaktuar në nenin 147/5 të Kushtetutës.

28. Gjykata gjatë votimit të çështjes mbi këto pretendime, për arsye se votat u ndanë në mënyrë të barabartë¹, nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj, të kërkuar nga neni 133/2 i Kushtetutës dhe neni 72/1 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të

¹ Votuan për pranimin: Bashkim Dedja; Petrit Plloçi; Sokol Berberi; Admir Thanza. Votuan për rrëzimin: Vladimir Kristo; Xhezair Zaganjori; Vitore Tusha; Altina Xhoxhaj.



Republikës së Shqipërisë”. Në këto kushte, Gjykata, në bazë të nenit 74 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, ka konkluduar se ky pretendim i kërkuesit duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, germa “a” dhe nenit 134, pika 1, germa “f” të Kushtetutës; neneve 72 dhe 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Refuzimin e pretendimit për papajtueshmëri me Kushtetutën të shprehjes “ose më të ulët” të nenit 42/1 të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj.
Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Piloçi, Sokol Berberi.

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, për sa i takon rrëzimit të kërkesës së paraqitur nga Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice. Në rastin konkret, kërkuesi ka pretenduar se fjalia “*Në këtë rast gjyqtari mund të transferohet edhe në institucionet e parashikuara në nenin 28/1 të këtij ligji, duke përfituar pagesën e gjyqtarit*”, në nenin 42/1 të ligjit nr. 9877 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, datë 18.2.2008 (ligji 9877/2008) nënkupton se gjyqtari transferohet pa pëlqimin e tij, duke shkelur kështu nenin 7 dhe 147/5 të Kushtetutës. Shumica, nëpërmjet arsyetimit të saj, ka bërë një interpretim pajtues të dispozitave të ligjit të kundërshtuar duke arritur në konkluzionin se, transferimi i gjyqtarit, në rastet e riorganizimit gjyqësor në institucionet e parashikuara nga neni 28/1, respekton garancitë kushtetuese të dhënies së pëlqimit dhe të ruajtjes së pagës së gjyqtarit, ndaj nuk jemi përpara cenimit të nenit 7 dhe 147/5 të Kushtetutës.

2. Nuk pajtohemi me këtë qëndrim të shumicës për arsyet që do të parashtrijmë më hollësisht në vijim.

3. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka theksuar në jurisprudencën e saj se parimi i pavarësisë së gjyqësorit përfshin një gamë të gjerë aspektesh, të cilat, të marra së bashku, krijojnë kushtet e nevojshme që gjykatat të përmbushin rolin dhe detyrat e tyre, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Garancitë kushtetuese që lidhen me palëvizshmërinë e gjyqtarëve, si dhe me paprekshmërinë e pagës e të përfitimeve të tjera, për shkak të funksionit, kanë ndikimin e tyre që gjyqtari të ushtrojë funksionin e tij në mënyrë të pavarur. Siguria në lidhje me pagën dhe me ushtrimin e qëndrueshëm të detyrës krijojnë kushtet e nevojshme që gjyqtarët të zbatojnë ligjin në mënyrë të drejtë e të paanshme (*shih vendimin nr. 11, datë 2.4.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuadrin e parimit të kontrollit dhe balancës ndërmjet pushteteve, varësia absolute e gjyqtarit ndaj ligjit është kushti dhe legjitimitimi i kësaj pavarësie (*shih vendimin nr. 20, datë 9.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Sipas nenit 147/5 të Kushtetutës transferimi i gjyqtarëve nuk mund të bëhet pa pëlqimin e tyre, përveç kur këtë e diktojnë nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor. Nisur nga interpretimi sistematik i kësaj dispozite, arrihet në konkluzionin se pëlqimi i gjyqtarit për transferimin e tij është një garanci kushtetuese për ruajtjen e parimit të palëvizshmërisë së gjyqtarit, duke qenë se transferimi pa pëlqim është parashikuar si përjashtim vetëm në rastet e riorganizimit të sistemit gjyqësor.

5. Ligji i kundërshtuar, në nenin 20, parashikon se gjyqtari nuk mund të lëvizë nga detyra, përveç rasteve kur: a) jep dorëheqjen; b) mbush moshën 65 vjeç, të daljes në pension; c) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi; ç) shkarkohet nga detyra. Në nenin 21/1, në mënyrë identike me nenin 147/5 të Kushtetutës, parashikohet se transferimi i gjyqtarëve nuk mund të bëhet pa pëlqimin e tyre, përveç se kur këtë e diktojnë nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor. Ndërsa neni 42/1 shkon më tej, duke parashikuar se, pavarësisht nga neni 21/1, kur një gjykatë mbyllet ose numri i gjyqtarëve zvogëlohet, për shkak të riorganizimit gjyqësor, gjyqtari mund të transferohet në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel ose më të ulët ose mund të transferohet edhe në institucionet e parashikuara në nenin 28/1 të këtij ligji¹, duke përfutur pagën e gjyqtarit.

6. Përderisa si Kushtetuta, ashtu edhe ligji nr. 9877/2008 parashikojnë transferimin e gjyqtarëve pa pëlqim në rastet e riorganizimit gjyqësor, pakica thekson se duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë garancive që ligji u ofron gjyqtarëve në këto lloj rastesh. Mosparashikimi i dhënies së pëlqimit duhet të shoqërohet me disa garanci ligjore, përndryshe përbën një cenim të statusit të gjyqtarit.

7. Edhe Karta Europiane për Statusin e Gjyqtarëve, duke vënë theksin tek rëndësia e dhënies së pëlqimit, parashikon ndër të tjera se një gjyqtar që ushtron funksionin në një gjykatë nuk mundet në parim të caktohet në një tjetër zyrë gjyqësore, madje as nëpërmjet ngritjes në detyrë, pa dhënë lirisht pëlqimin e tij. Përjashtim nga ky rregull lejohet vetëm në rastet kur transferimi parashikohet dhe është shprehur si sanksion disiplinor, në rastet e një ndryshimi të ligjshëm të sistemit gjyqësor dhe në rastet e caktimit të përkohshëm të gjyqtarit për të përforcuar një gjykatë fqinje me kohëzgjatje maksimale të përcaktuar rigorozisht nga ligji, pa cenuar aplikimin e dispozitës së paragrafit 1.4 (shih paragrafin 3.4 të Kartës²). Sipas këtij të fundit “ligji i jep mundësinë çdo gjyqtari, i cili mendon se të drejtat e tij sipas këtij ligji apo përgjithësisht pavarësia e tij cenohet, t'i drejtohet një autoriteti të pavarur që disponon mjetet efektive për vendosjen në vend të së drejtës së shkelur. Raporti shpjegues i Kartës shprehet se në rast transferimi pa pëlqim të gjyqtarit, për shkak të ndryshimit të këtij problemi, theksohet se sipas paragrafit 1.4 gjyqtari ka të drejtën e apelit përpara një autoriteti të pavarur i cili heton mbi ligjshmërinë e transferimit³.

8. Në vështrim të nenit 42/1 të ligjit nr. 9877/2008, *supra*, pakica vëren se kjo dispozitë parashikon tri lloje transferimesh në rastet e riorganizimit gjyqësor: a) transferim në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel; b) transferim në një gjykatë të një niveli më të ulët; c) transferim në institucionet e parashikuara në nenin 28/1 të ligjit (jashtë sistemit gjyqësor). Duke pasur parasysh se objekt i kësaj pakice është transferimi i gjyqtarëve jashtë sistemit gjyqësor, edhe argumentet vijuese do t'i referohen këtij lloj transferimi.

9. Së pari, në vlerësimin e pakicës, nga përmbajtja e nenit 42/1 nuk rezulton e qartë nëse transferimi në pozicione jashtë sistemit gjyqësor bëhet kur nuk është i mundur sistemimi në një gjykatë të të njëjtit nivel ose më të ulët apo gjyqtari mund të zgjedhë midis transferimit brenda pushtetit gjyqësor (gjykatë e të njëjtit nivel ose më e ulët) dhe një pozicioni jashtë pushtetit gjyqësor. Së dyti, pakica, bazuar në interpretimin sistematik dhe logjik të kësaj dispozite, në ndryshim nga qëndrimi i shumicës, çmon se për transferimet jashtë sistemit gjyqësor për arsye riorganizimi, nuk kërkohet konsensusi i gjyqtarit. Gjyqtari është i detyruar të transferohet në pozicionet që parashikon neni 42/1 dhe kjo përforcohet akoma më tepër nga leximi i paragrafit 3 të nenit 42, ku thuhet shprehimisht se “*në rast se transferimi, sipas pikës 1 të këtij neni, refuzohet...(...), atëherë gjyqtari shkarkohet nga detyra*”. Mbi

¹ Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Gjykatë Kushtetuese, Gjykatë e Lartë, Gjykatë e Apelit, Prokurori, Shkolla e Magjistraturës

² European Charter on the Statute of Judges shih <http://www.judicialcouncil.gov.az/Law/echarte.pdf>

³ *Ibid*, <http://www.judicialcouncil.gov.az/Law/echarte.pdf>



bazën e kësaj linje arsytimi pakica nuk është dakord me interpretimin pajtues të shumicës se transferimi jashtë sistemit gjyqësor në rastet e parashikuara nga neni 42/1 bëhet me pëlqimin e gjyqtarit, në vështrim pajtues me nenin 28/1.

10. Për të konkretizuar këtë qëndrim pakica sjell në vëmendje se ligji 9877/2008 parashikon dy lloje transferimesh të gjyqtarit jashtë sistemit gjyqësor, të dallueshme nga njëra tjetra: sipas nenit 28/1 “*gjyqtarët, me kërkesë të institucioneve e pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmës ligjor ose këshilltar të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës së Apelit, prokuror, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim të këtij afati gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës. Trajtimi financiar i gjyqtarëve gjatë kësaj periudhe bëhet nga institucionet përkatëse duke i dhënë pagën më të lartë ndërmjet dy pagave*”. Ndërsa, sipas nenit 42/1, **për nevojat e riorganizimit gjyqësor** gjyqtarët mund të transferohen edhe në institucionet e parashikuara në nenin 28/1, duke përfituar pagën e gjyqtarit. Pavarësisht se në këtë rast ligji hesht për sa i përket dhënies së pëlqimit, pakica arrin në konkluzionin se ky transferim, sipas kuptimit normativ të dispozitës, bëhet pa pëlqim. Siç duket qartë nga krahasimi i këtyre dispozitave, transferimi jashtë sistemit gjyqësor në rastet e parashikuara nga neni 28/1 është i ndryshëm nga transferimi jashtë sistemit gjyqësor në rastet e parashikuara nga neni 42/1. Kështu, transferimi sipas nenit 28/1 bëhet me kërkesë të institucioneve, pëlqim të gjyqtarit dhe duke ofruar një trajtim financiar sa paga më e lartë ndërmjet dy pagave. Ndërsa transferimi sipas nenit 42/1 bëhet për arsye të riorganizimit gjyqësor, pa pëlqim dhe paga e ofruar është sa paga e gjyqtarit. Pra, pakica është e mendimit se nuk mund të bëhet një interpretim pajtues i këtyre dy dispozitave.

11. Pakica çmon se transferimi i gjyqtarit në një pozicion jashtë sistemit gjyqësor, pa pëlqim, sipas parashikimit të nenit 42/1 të ligjit nr. 9877/2008, nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 147/5 të Kushtetutës. Duke bërë një interpretim logjik dhe sistematik të normës kushtetuese, arrihet në përfundimin se kjo dispozitë parashikon kushtet e transferimit të gjyqtarit vetëm brenda sistemit gjyqësor. Transferimi jashtë sistemit gjyqësor, në rastet e riorganizimit, për të qenë në harmoni me parimin e palëvizshmërisë dhe me garancitë kushtetuese për pavarësinë e gjyqësorit, duhet të bëhet me pëlqimin e gjyqtarit dhe duhet që ligji ta parashikojë këtë lloj transferimi si një mjet të jashtëzakonshëm sistemimi në kushtet e pamundësisë për të sistemuar gjyqtarin brenda sistemit gjyqësor. Për më tepër, gjyqtari i transferuar në institucionet jashtë pushtetit gjyqësor, të përcaktuara në nenin 28/1 të ligjit nr. 9877/2008, mund të bëhet objekt i masave disiplinore administrative nga ana e titullarit të institucionit, çka do të përbënte një ndikim të papërshtatshëm, duke cenuar garancitë e pushtetit gjyqësor, në kuptim të neneve 7 dhe 145/1 të Kushtetutës. Bazuar mbi arsyetimin e mësipërm, pakica mbështet qëndrimin se fjalia “*Në këtë rast gjyqtari mund të transferohet edhe në institucionet e parashikuara në nenin 28/1 të këtij ligji, duke përfituar pagesën e gjyqtarit*”, në nenin 42/1 të ligjit nr. 9877/2008, duhej shfuqizuar, dhe jo të bëhej interpretim pajtues i saj, siç është shprehur shumica.

12. Në një qasje krahasuese me sistemin italian, rezulton se në këtë të fundit, për caktimin e gjyqtarëve në poste administrative shtetërore, është i domosdoshëm autorizimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që përbën një garanci ligjore, për arsye se Këshilli i Lartë i Drejtësisë vlerëson nëse funksioni jashtë sistemit gjyqësor përputhet me statusin e gjyqtarit, pra vlerëson përputhshmërinë e funksionit me vlerat e pavarësisë dhe autonomisë tipike të funksionit juridiksional¹. Caktimi në një detyrë jashtë sistemit gjyqësor, në sistemin italian, mund të bëhet me kërkesë të institucionit dhe vetëm me pëlqimin e gjyqtarit, që jepet në formë të shkruar, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin që do të bëjë Këshilli i Lartë i Drejtësisë². Në rastet kur parashikohet një transferim i gjyqtarit pa pëlqim, për arsye objektive, legjislatori italian i ka dhënë gjyqtarit disa garanci ligjore, si vijon: 1) Këshilli i Lartë i Drejtësisë është i detyruar që të dëgjojë gjyqtarin që do të transferohet dhe të

¹ Circolare sugli incarichi extragiudiziari (Circolare n. P – 19612/2010 del 4 agosto 2010 - Delibera del 29 luglio 2010)

² Circolare n. P- 2766 dell'8 febbraio 2008 del Consiglio Superiore della Magistratura

marrë në konsideratë memoriet me shkrim që ai paraqet; 2) vendimi përfundimtar i transferimit duhet të shpjegojë konkretisht përdorimin e pushtetit diskrecional të ushtruar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë me qëllim që të garantohet pavarësia dhe prestigji i funksionit juridiksional, në kushtet e mungesës së përgjegjësisë së gjyqtarit të interesuar¹. Gjykata Kushtetuese Italiane është shprehur se të drejtat e të interesuarit janë përshtatshëmrisht të garantuara me mundësinë që i është dhënë atij të dëgjohet përpara marrjes së vendimit përfundimtar²; 3) vendimi përfundimtar, si akt administrativ, është i ankimeshëm në juridiksionin administrativ për motive ligjore.

13. Pakica vlerëson të mos shprehet në lidhje me shfuqizimin e shprehjes “më të ulët”, në nenin 42/1 të ligjit nr. 9877/2008, duke pasur parasysh se ky pretendim është refuzuar nga Gjykata në përputhje me nenin 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (ligji nr. 8577/2000). Pavarësisht nga ky qëndrim i mbajtur nga Gjykata, pakica është e mendimit se, në bazë të nenit 73/3 të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata mund të riçelto seancën në mënyrë që të mundësohej një vendimmarrje e saj në këtë drejtim.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Petrit Ploçi.

VENDIM
Nr.6, datë 17.2.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“

me sekretare Brunilda Bara, në datat 19.5.2011 dhe 23.6.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 14/3 Akti, që i përket:

KËRKUES: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

Ministria e Financave, përfaqësuar nga Violanda Theodhori, me autorizim.

OBJEKTI: Zgjidhja e konfliktit ligjor ndërmjet vendimit unifikues nr.12, datë 14.9.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe akteve të tjera ligjore në fushën e sigurimeve.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1, shkronja “d”, dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 68 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Altina Xhoxhaj, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave, që kërkuan pranimin e kërkesës dhe, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

¹ Cons. Stato, Sez.IV, 26.4.1985, n.621

² Corte Cost. 19.11.2002, n.457, in Foro It.2003, I, 716, in Dir.Giust. 2002, 43, 42



VËREN:

I

1. Përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (gjykata referuese) është paraqitur për shqyrtim një çështje civile me objekt detyrimin e shoqërisë “Interalbanian” sh.a. të paguajë në favor të palës paditëse F.R. etj, dëmin real pasuror dhe jopasuror të shkaktuar si pasojë e aksidentit automobilistik me pasojë vdekjen e shtetasit A.R. Gjatë shqyrtimit të çështjes, gjykata referuese ka konstatuar se për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, ajo duhet t’i referohet dy rregullimeve ligjore që kanë trajtuar në mënyra të ndryshme të njëjtat çështje, nga njëra anë vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë, i cili është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga gjykatat më të ulëta dhe, si i tillë, merr fuqinë e ligjit, dhe nga ana tjetër aktet ligjore në fuqi në fushën e sigurimeve. Për këto arsye, me vendimin e datës 29.9.2010, gjykata referuese ka vendosur pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), duke parashtruar në thelb se:

- Duke pasur parasysh nenin 116 të Kushtetutës (që rendit aktet normative që kanë fuqi në Republikën e Shqipërisë) dhe nenin 141/2 të Kushtetutës (që përcakton funksionin unifikues të Gjykatës së Lartë), është krijuar një konflikt ligjor, i cili duhet të zgjidhet nga Gjykata.

- Një situatë e tillë e konfliktit/përplasjes midis këtyre akteve ligjore në fuqi çon në cenimin e parimit të sigurisë juridike.

- Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë, në raport me aktet ligjore që kanë rregulluar këtë fushë, ka mangësi për sa i përket dallimit të përgjegjësisë jashtëkontraktore që buron nga shkaktimi i dëmit, përgjegjësisë së shoqërive të sigurimit për dëmet e shkaktuara si rezultat i një aksidenti automobilistik, si dhe të dëmtuarve që legjitimohen të kërkojnë shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga një aksident automobilistik. Këto mangësi shkaktojnë një situatë jokushtetutshmërie, që ka të bëjë me shkeljen e parimit të sigurisë juridike dhe atij të barazisë para ligjit, të sanksionuar nga nenet 4 dhe 18 të Kushtetutës.

- Vendimi unifikues e ka zgjeruar numrin e përfituesve që legjitimohen të kërkojnë dëmin pasuror dhe jopasuror nga shoqëritë e sigurimit duke prishur balancën e skemës së sigurimit. Kjo situatë, në aspektin kushtetues, përbën një diskriminim të këtyre subjekteve në raport me subjektet e tjera të kësaj skeme, në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës.

2. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, parashtrori në mënyrë të përmbledhur se:

2.1 Për legjitimitimin e kërkesit:

- Në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës, gjyqtari vë në lëvizje procedurën e kontrollit incidental vetëm për norma të llojit “ligj” të cilave ai i nënshtrohet, që në aspektin formal nënkupton aktin normativ të miratuar nga Kuvendi. Kjo do të thotë se gjyqtari nuk mund të iniciojë kontroll kushtetues të një norme që ka renditje më të ulët se ligji, siç është rasti për gjykim ku kërkesi ka paraqitur për kontroll një udhëzim të Ministrit të Financave. Në lidhje me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë, lihet në vlerësim të Gjykatës analiza për llojin dhe renditjen hierarkike të tij, çka i shërben interpretimit të nenit 145 të Kushtetutës për të nxjerrë konkluzione, për të ardhmen, nëse legjitimohet një gjyqtar i zakonshëm të kundërshtojë një vendim unifikues në Gjykatë.

- Në kuptim të nenit 131 të Kushtetutës, Gjykata nuk ka juridiksion për të shqyrtuar përplasjet, devijimet dhe masën e harmonizimit midis dy akteve normative me njëra-tjetrën. Zgjidhja e përplasjeve midis vendimit unifikues dhe udhëzimit të Ministrit të Financave me Kodin Civil nuk përfshihet në juridiksionin e Gjykatës.

- Udhëzimi i Ministrit të Financave është shfuqizuar tashmë dhe, si i tillë, nuk mund të japë shkas për nxjerrjen e një vendimi nga Gjykata mbi vlerën e tij.

2.2 Për themelin e kërkesës:

- Gjykata referuese ka dashur të prezantojë një problematikë që përfaqësohet përmes kolizionit të dy akteve të detyrueshme për zbatim nga sistemi gjyqësor, vendimet e Gjykatës së Lartë për njësimin e praktikës gjyqësore nga njëra anë dhe ligjet nga ana tjetër. Edhe pse çështja e kolizionit të ligjeve nuk hyn në juridiksionin kushtetues, praktikisht mund të ndodhë që për çështje të ngjashme të jepen zgjidhje cilësisht të ndryshme nga gjykatat dhe ky trajtim i diferencuar do të prekte standardet kushtetuese të barazisë para ligjit (neni 18 i Kushtetutës) dhe barazisë brenda procesit të rregullt ligjor (neni 42 i Kushtetutës).

- Në rastin në gjykim, Gjykata duhet të përcaktojë dimensionet e detyrueshmërisë së zbatimit të një vendimi unifikues të Gjykatës së Lartë prej gjykatave të niveleve më të ulëta. Çështja bëhet delikate në rastet kur i njëjti argument i detajuar fillimisht nëpërmjet një vendimi unifikues, gjen më vonë një trajtim nga një ligj specifik i miratuar nga Kuvendi. Në këtë rast duhet të sqarohet prevalenca e zbatimit mes këtyre dy akteve, veçanërisht kur mes tyre ka dhe ndryshime cilësore në trajtesën që i bëjnë argumentit përkatës.

3. *Subjekti i interesuar, Ministria e Financave, e përfaqësuar në gjykim nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, parashtroi në mënyrë të përmbledhur se:*

- Vendimi unifikues tejkalon kompetencat e pushtetit gjyqësor. Duke vendosur kufijtë e dëmshpërblimit Gjykata e Lartë ka marrë kompetenca që i takojnë organit ligjvënës, në kundërshtim me parimin e ndarjes së pushteteve, të sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës.

- Vendimi unifikues, në krahasim me përmbajtjen e ligjit ligjit nr.10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, zgjeron rrethin e personave përfitues nga shoqëritë e sigurimit në rastin e një aksidenti automobilistik. Gjykata e Lartë, në këtë mënyrë, ka krijuar një normë të re, në kundërshtim me Kodin Civil, dhe që cenon parimin e sigurisë juridike.

- Vendimi unifikues njeh të drejtën e dëmshpërblimit për çdo lloj dëmi jopasuror jashtëkontraktor, pa asnjë lloj kufizimi. Një interpretim i tillë i Kodit Civil nuk mund të shtrihet edhe për shpërblimin e dëmit nga ana e shoqërive të sigurimit, sepse këto të fundit nuk kanë detyrimin ti paguajnë të gjithë të dëmtuarve dhe as të gjithë vlerën e dëmit. Në rastin e kontratës së sigurimit është ligji ai që ka përcaktuar primin (shpërblimin) që derdh çdo i siguruar dhe, si rrjedhojë, në raport me këtë përcaktohen edhe kufijtë e shumës që i paguan shoqëria e sigurimit personave të dëmtuar.

- Vendimi unifikues cenon sigurinë juridike edhe në një aspekt tjetër. Ai është kontradiktor për sa i përket përcaktimit të dëmshpërblimit për dëmin moral, ku fillimisht shprehet për caktimin e tij bazuar në bindjen e brendshme të gjykatës dhe më pas shprehet se ai duhet të përcaktohet bazuar në tabelat ligjore të dëmshpërblimeve. Kjo ka sjellë përshtjellim e paqartësi në praktikë, sepse gjykatat i referohen herë tabelave ligjore e herë praktikës dhe bindjes së tyre të brendshme.

II

4. Gjykata Kushtetuese vëren se kërkesa për kontroll incidental, që përbën mjetin e aksesit të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës, sipas të cilit, kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën nuk i zbatojnë ato, por pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen kësaj Gjykate, për t’u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e tij.

5. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese është konkretizuar nga neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i cili përcakton disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata referuese për të iniciuar gjykimin incidental: së pari, gjatë një procesi gjyqësor ajo duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); së dyti, duhet të parashtrojë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e ligjit ose dispozitave të tij duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës (shih vendimet nr. 13, datë 4.5.2009 dhe nr. 2, datë 3.2.2010 të Gjykatës Kushtetuese). Para marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, gjykata referuese duhet të konkludojë se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa i dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës



Kushtetuese. Pra, duhet të çmojë se ligji që vlerëson si jokushtetues do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete. Në të kundërt, nëse gjykata referuese çmon se një ligj nuk do të zbatohet nga ana e saj për zgjidhjen e çështjes, edhe pse sipas saj vlerësohet si jokushtetues, ajo duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes (*shih vendimet nr.5, datë 6.3.2009; nr.13, datë 04.5.2009 dhe nr.30, datë 17.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Gjykata vëren se objekti dhe shkaqet e kërkesës me të cilën ngrihet çështja e kushtetutshmërisë përbëjnë thelbin (*thema decidendum*) e gjykimit kushtetues. Në lidhje me objektin e kërkesës konstatohet se gjykata referuese ka kërkuar zgjidhjen e konfliktit ligjor midis vendimit unifikues nr. 12, datë 14.9.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe akteve të tjera ligjore në fuqi në fushën e sigurimeve, kurse për sa i përket shkaqeve të kërkesës ajo shprehet se ky konflikt cenon parimin e sigurisë juridike dhe atë të barazisë para ligjit. Pavarësisht sa më sipër Gjykata vëren se, në thelb të kërkesës, gjykata referuese ngre pretendime në lidhje me pajtueshmërinë me këto parime kushtetuese të vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë.

7. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjeve është kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe sidomos e Gjykatës së Lartë. Në këtë kuptim Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës së Lartë autoritetin të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore, pra të mbajë qëndrime në çështje të veçanta me qëllim unifikimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme. Ky funksion ushtrohet nga Gjykata e Lartë duke tërhequr për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara. Sa më sipër vjen si pasojë e pozicionit të saj si organi më i lartë i sistemit gjyqësor dhe lidhet me funksionin e përgjithshëm të saj për të siguruar uniformitetin e interpretimit të normave ligjore nga ana e gjyqtarëve të zakonshëm, përmes përcaktimit të linjave të interpretimit të cilave gjyqtarët duhet t'u përmbahen. Përfundimet në të cilat arrin Gjykata e Lartë nuk vlejnë vetëm për rastin konkret të zgjidhur prej saj, por për të gjitha rastet e ngjashme për gjykatat e tjera, ose vetë kolegjet e thjeshta të asaj gjykate. Barazia në të drejta, mes të tjerash, përcakton edhe detyrimin për vendimmarrje të njëjtë dhe të qëndrueshme në çështje të ngjashme nga gjykatat e zakonshme.

8. Veprimtaria gjyqësore konsiston në zbatimin e dispozitës ligjore (e hartuar përgjithësisht në terma të përgjithshëm dhe abstraktë) në një çështje specifike konkrete. Megjithatë, jo gjithmonë është e mundur për gjyqtarin të identifikojë normën (rregullin juridik) e zbatueshme në rastin në shqyrtim dhe një kërkim i tillë kryhet prej tij duke përdorur një seri kriteresh interpretativë. Interpretimi i ligjit ka si qëllim, së pari, ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore, por kur ajo kryhet me qëllim zëvendësimit e asaj që shfaqet si boshllëk i rendit juridik (mungesa e një dispozite të shprehur nga e cila të nxirret norma që duhet zbatuar në rastin konkret) ajo kthehet në një veprimtari që i ngjan asaj të krijimit të normave të reja juridike.

9. Gjykata vlerëson t'i referohet konceptit të së "drejtës së gjallë", e kuptuar përgjithësisht në sensin e ekzistencës së një "jurisprudence konstante", "të konsoliduar" mbi një dispozitë të caktuar ligjore (duke pasur pra parasysh mënyrën se si ajo "jeton" në realitetin konkret). Përdorimi i formulës së "të drejtës së gjallë" e ndihmon Gjykatën të përcaktojë raportet me gjyqtarët e zakonshëm në terrenin e interpretimit të së drejtës (e njohur si detyrë që u takon posaçërisht këtyre të fundit) duke marrë në lidhje me këtë një qëndrim vetëkufizues (*self restraint*) në kuptimin që, nëse një e drejtë e tillë e gjallë ekziston, Gjykata e mban parasysh dhe (me disa përjashtime) nuk ndalet të bëjë një interpretim të ndryshëm, edhe atje ku i duket asaj më bindëse. Kompetenca e Gjykatës ndalet përpara interpretimit konstant jurisprudencial pasi, edhe në autonominë e saj të plotë të gjykimit Gjykata nuk mund të mos ketë parasysh një interpretim të tillë që i njeh normës legjislativë vlerën e saj efektive në jetën juridike, duke qenë se normat janë jo ato që propozohen në mënyrë abstrakte por ato që zbatohen në punën e përditshme të gjyqtarit, që synon t'i bëjë konkrete dhe efikase (*shih vendimin nr.350, datë 13-21 nëntor 1997, të Gjykatës Kushtetuese Italiane*).

10. Qëllimi i Gjykatës nuk është të vërë në diskutim vlerën që kanë vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë në rendin juridik dhe as detyrimin ligjor që kanë gjykatat më të ulëta që të marrin parasysh dhe zbatojnë në çështje analoge zgjidhjet e dhëna në këto vendime. Gjykata vëren se në rastin në shqyrtim mënyra si e ka paraqitur gjykata referuese këtë çështje del jashtë kuadrit të parimit të sigurisë juridike dhe atij të barazisë përpara ligjit. Gjykata thekson se çështja e shtruar para saj, në thelb, ka të bëjë me zbatimin e parimit të veprimit të ligjit të ri, të posaçëm, në kohë.

11. Gjykata vëren se kuadri ligjor në Shqipëri për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit është rregulluar fillimisht me dekretin nr. 295, datë 15.9.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë”, i miratuar me ligjin nr. 7641, datë 1.12.1992 “Për miratimin me disa ndryshime të dekretit nr. 295, datë 15.9.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë”.

12. Gjykata e Lartë, nisur nga qëndrimet e ndryshme të gjykatave për sa i përket zbatimit të ligjit lidhur me rrethin e personave të dëmtuar, të drejtën e përfitimit të dëmshpërblimit për dëmet jashtëkontraktore dhe mënyrën e llogaritjes së tij, veçanërisht atij jopasuror, vlerësoi se kishte vend për të mbajtur një qëndrim të unifikuar në lidhje me këto çështje. Me vendimin nr. 12, datë 14.09.2007 Gjykata e Lartë unifikoi praktikën gjyqësore në lidhje me zbatimin e neneve 608, 609, 625, 643/a e vijues të Kodit Civil, duke u shprehur, në thelb, për subjektet që kanë të drejtën subjektive (legjitimitimin aktiv) për të kërkuar dëmshpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror të pësuar, figurën e dëmit biologjik apo dëmit mbi shëndetin (si figurë e posaçme e dëmit jopasuror), figurën e dëmit moral dhe atij ekzistencial, metodologjinë e përlllogaritjes së masës së dëmshpërblimit etj. Në lidhje me masën e dëmshpërblimit vendimi unifikues shprehet se gjykatat duhet të mbështeten në vlerat përkatëse të përcaktuara nga aktet ligjore në fuqi dhe vetëm në mungesë të këtyre kriterëve tabelare ato vendosin sipas bindjes së tyre të brendshme, duke lënë të lirë mundësinë e përcaktimit të masës së dëmshpërblimit rast pas rasti.

13. Disa muaj pas daljes së vendimit unifikues u hartua akti normativ, udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 24, datë 15.11.2007 “Mbi trajtimin e dëmeve të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, kurse në vitin 2009 hyri në fuqi ligji nr.10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i cili rregulloi tërësisht fushën e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit. Ky ligj shfuqizoi ligjin nr.7641, datë 1.12.1992 dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të këtij të fundit. Në nenin 26 të ligjit është parashikuar edhe kufiri i mbulimit të dëmit nga shoqëritë e sigurimit.

14. Gjykata ka vlerësuar se Kuvendi, si organ ligjvënës, ka të drejtë të zbatojë apo konkretizojë politika të caktuara për zhvillimin e vendit në tërësi, apo t’u përgjigjet prioriteteve apo problemeve të ndryshme të vendit (*shih vendimin nr. 29, datë 31.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” ka pasur si synim rregullimin e plotë të fushës së sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, duke parashikuar detyrimet e siguruesit dhe të të siguruarit, kushtet dhe tarifatat e sigurimit të detyrueshëm, të drejtën e palës së dëmtuar të paraqesë kërkesë për dëmshpërblim, procedurën dhe afatet për rregullimin e shpërblimit të dëmeve, përgjegjësinë e shoqërisë së sigurimit dhe shumën e siguruar (kufiri i mbulimit) sipas figurave të dëmit etj. Ai përcakton tashmë edhe kriteret tabelare ligjore ku duhet të mbështeten gjykatat për përcaktimin e vlerës së dëmshpërblimit, të cilat mungonin në momentin e daljes së vendimit unifikues. Ligji i ri, duke bërë një rregullim specifik të formulës së llogaritjes, ka vendosur rregulla të përgjithshme për çdo subjekt sigurimi dhe standarde të njëjta në trajtimin dhe vlerësimin e pagesave të dëmeve në territorin e Republikës së Shqipërisë. Me këtë ligj të posaçëm ligjvënësi plotësoi boshllëqet ligjore që ekzistonin në këtë fushë dhe që nxitën dhe sollën nevojën për interpretimin e disa dispozitave të përgjithshme të Kodit Civil nga ana e Gjykatës së Lartë.

15. Gjykata vëren se parimi i përgjithshëm është se ligjet i shtrijnë efektet për marrëdhëniet juridike që lindin pas hyrjes së tyre në fuqi. Teoria e së drejtës pranon se fuqia prapavepruese zbatohet si përjashtim, për shembull, në ligjet penale favorizuese, në ligjet që ndërhyjnë për të rregulluar situata të paligjshme të krijuara më parë, në ligjet që interpretojnë anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm dhe në ndonjë rast tjetër ku paraqitet domosdoshmëria për të shmangur pasoja të rënda, negative ose të pandreqshme (*shih vendimin nr. 9, datë 26.2.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Kuvendi nuk



ndalohet të miratojë ligje retroaktive ose të legalizojë me efekte retroaktive praktika ose marrëdhënie ekzistuese, të cilat njihen në doktrinën kushtetuese si ligje legalizuese, por kjo ndërhyrje duhet të justifikohet nga interesi publik dhe kusht për miratimin e këtyre ligjeve, që legalizojnë praktika ekzistuese, është që ato të mos shkelin autoritetin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave (shih vendimin nr.31, datë 18.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

16. Gjykata thekson se ligji i ri nuk mund të ndërhyjë në ato marrëdhënie juridike të cilat janë zgjidhur me vendim të formës së prerë, pra midis ligjit të ri dhe çështjeve që përbëjnë *res judicata* nuk mund të ketë lidhje juridike. Në rastin në shqyrtim, në këndvështrimin e respektimit të parimit të sigurisë juridike, nuk konstatohet që qëllimi i ligjvënësimit të ketë qenë miratimi i një ligji specifik *ad hoc* me qëllim që të influencojë në përfundimin e një çështjeje që është duke u shqyrtuar para gjykatës, apo rregullimi me efekte prapavepruese i marrëdhënies që kanë lindur para hyrjes së këtij ligji në fuqi.

17. Në bazë të nenit 145 të Kushtetutës, gjyqtarët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve, duke respektuar hierarkinë e burimeve të së drejtës. Bazuar në nenin 116 të Kushtetutës, marrëdhëniet midis normave juridike bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlerëshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përfutur kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike (shih vendimin nr. 3, datë 20.2.2006 të Gjykatës Kushtetuese). Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor (shih vendimin nr. 2, datë 3.2.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

18. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se është detyrimi i gjykatës referuese dhe jo i kësaj Gjykate të verifikojë dhe përcaktojë, me qëllim identifikimin e ligjit të zbatueshëm në çështjen konkrete, momentin e lindjes së marrëdhënies objekt gjykimi në raport me momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. Kjo bazuar edhe në parimet që udhëheqin sistemin tonë juridik, i cili bën pjesë në familjen e *Civil Law*. Ligji i mëvonshëm nuk lidhet me përcaktimet që ka bërë më parë praktika gjyqësore përderisa, siç u përmend më sipër, në bazë të nenit 145 të Kushtetutës gjyqtarët i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve, duke respektuar hierarkinë e burimeve të së drejtës.

19. Si përfundim, Gjykata rithekson se në thelb kjo çështje lidhet me fuqinë e vendimit unifikues përballë efekteve në kohë të ligjit të posaçëm në fushën e sigurimeve, megjithatë, duke pasur parasysh problematikën e ngritur në kërkesë, të konfirmuar edhe nga parashtimet e subjekteve të interesuara në seancë gjyqësore, Gjykata vlerësoi se duhej të ndalej në parashtimin e disa parimeve të përgjithshme, si më sipër, me qëllim orientimin e gjykatave në zgjidhjen e kësaj problematike. Gjykata e bën këtë sa herë lind nevoja për të rikonfirmuar rëndësinë e respektimit të parimeve të tilla kushtetuese si siguria juridike, barazia para ligjit, apo hierarkia e burimeve të së drejtës, si në rastin në fjalë. Gjykata konfirmon qëndrimin e saj se një çështje nuk hyn në sferën e kompetencës së Gjykatës nëse paraqet probleme të veprimit të ligjit në kohë (siç është rasti në shqyrtim) apo kërkon vlerësime lidhur me vendosjen respektive hierarkike të normave në konflikt, të cilat si të tilla hyjnë në sferën e kompetencës së gjykatës referuese. Për sa më sipër kërkesa është e papabuar dhe si e tillë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “a”, 134, pika 1, shkronja “d” dhe 145/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 68, 69, 70, 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,¹

¹ Gjyqtari S. Berberi votoi pro rrëzimit të kërkesës, por me arsyetim paralel.

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar) Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi.

MENDIM PARALEL

Në çështjen me kërkues Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me objekt “Zgjidhja e konfliktit ligjor ndërmjet vendimit unifikues nr. 12, datë 14.9.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe akteve të tjera ligjore në fushën e sigurimeve”, pajtohem me vendimin e shumicës për rrëzimin e kërkesës, por kam mendim të ndryshëm për sa i takon arsyeve për këtë qëndrim, ndaj e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim paralel.

Në qëndrimin e saj për këtë çështje, shumica, fillimisht, pranon se në thelb të kërkesës, gjykata referuese ngre pretendime në lidhje me pajtueshmërinë me disa parime kushtetuese të vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë (paragrafi 6 i vendimit) por, me arsyetimet e shprehura në vijim, pa i dhënë përgjigje këtyre pretendimeve, shprehet se “çështja e shtruar para saj, në thelb, ka të bëjë me zbatimin e parimit të veprimit të ligjit të ri, të posaçëm, në kohë”. Në përfundim, shumica arrin në konkluzionin se çështja nuk hyn në sferën e kompetencës së Gjykatës Kushtetuese, për arsye se problemet e ligjit në kohë apo të hierarkisë së normave në konflikt, hyjnë në sferën e kompetencës së gjykatës referuese. Ndryshe nga ky përfundim, çmoj se shumica, në arsyetimet e shprehura në vendim, ka dalë jashtë objektit të gjykimit kushtetues, duke bërë vlerësime dhe analizuar aktet ligjore të çështjes konkrete (shih parag. 14, 18), të cilat i përkasin juridiksionit të zakonshëm gjyqësor. Mendoj se, fillimisht, shumica duhet t’i jepte përgjigje pyetjes nëse legjitimohet apo jo gjyqtari i juridiksionit të zakonshëm të kërkojë kontrollin kushtetues të një vendimi unifikues të Gjykatës së Lartë, në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës. Për më tepër, ky pretendim është ngritur dhe nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, dhe për rrjedhojë duhej që të kishte marrë përgjigje në vendim. Në vijim do t’i përgjigjem këtij pretendimi duke argumentuar se gjyqtari i juridiksionit të zakonshëm nuk mund të kërkojë kontrollin kushtetues të një vendimi unifikues të Gjykatës së Lartë, në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës, dhe, për rrjedhojë, kërkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duhet të ishte rrëzuar për këtë shkak.

Kushtetuta i ka njohur Gjykatës së Lartë të drejtën të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore (neni 141/2). Kjo realizohet nga Gjykata e Lartë duke tërhequr për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore. Përfundimet në të cilat arrin Gjykata e Lartë nuk vlejnë vetëm për rastin konkret të zgjidhur prej saj, pasi gjyqtarët/gjykatat e tjera që vendosin për raste identike/të ngjashme ose vetë Kolegjet e kësaj gjykate nuk mund të vijnë në përfundime të ndryshme nga ato në të cilat ka arritur Gjykata e Lartë. Detyrueshmëria për zbatimin e këtyre vendimeve parashikohet edhe në nenin 32/f të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit “moszbatimi i vendimit unifikues, (...) të Gjykatës së Lartë, (...) përbën shkelje që diskrediton rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit”. Po kështu edhe neni 438 i Kodit të Procedurës Penale sanksionon se vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara është i detyrueshëm për gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme.

Procesi i njësimimit të praktikës gjyqësore, nga njëra anë, dhe detyrimi i gjykatave të zakonshme për të zbatuar vendimet unifikuese, nga ana tjetër, i shërbejnë vlerave të uniformitetit, qëndrueshmërisë dhe parashikueshmërisë në zbatimin e së drejtës. Në këtë mënyrë, parandalohet arbitrariteti në zbatimin e ligjit dhe garantohen parimet kushtetuese të sigurisë juridike dhe barazisë përpara ligjit. Edhe GJEDNJ-ja, në mbështetje të kësaj ideje, është shprehur se “...Gjykata mendon se është në interes të sigurisë juridike, të parashikueshmërisë dhe të barazisë para ligjit që ajo të mos shmanget pa motiv të vlefshëm nga precedentët.” (shih çështjen Chapman kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 18.1.2001)



Siç është evidentuar edhe nga shumica, kërkesa në rrugë incidentale, nëpërmjet së cilës gjykatat e zakonshme kanë akses në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës dhe neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Sipas nenit 145/2 të Kushtetutës, “kur gjykata ose gjyqtari gjatë një procesi gjyqësor dhe në çdo kohë, kryesisht ose me kërkesë të palëve, çmon se ligji është antikushtetues dhe kur ka lidhje të drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, nuk e zbaton atë, duke vendosur pezullimin e shqyrtimit të mëtejshëm të çështjes dhe dërgimin e materialeve të saj Gjykatës Kushtetuese, për t’u shprehur për kushtetutshmërinë e ligjit”. Në vendimin e saj gjykata apo gjyqtari duhet të përcaktojë dispozitat e ligjit që ata çmojnë se janë të papajtueshme me normat ose parimet e Kushtetutës. Neni 68 i ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese përcakton disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata ose gjyqtari për të iniciuar kontrollin incidental. Së pari, gjykata, gjatë një procesi gjyqësor duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); së dyti, gjykata duhet të parashtrijë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e ligjit (të një ose të disa dispozitave të tij) duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës.

Neni 131 i Kushtetutës parashikon se Gjykata Kushtetuese vendos për pajtueshmërinë e ligjit dhe akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën. Sipas interpretimit literal që i bëhet kësaj dispozite, çështja e kushtetutshmërisë që i nënshtrohet gjykimit kushtetues gjatë kontrollit incidental ka si objekt një ligj ose një akt që ka forcën e ligjit, të cilin gjykata referuese e konsideron si të vesuar nga pikëpamja kushtetuese.

Në çështjen konkrete, gjykata referuese ka iniciuar kontrollin incidental, duke pretenduar se vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë cenon disa parime kushtetuese (sigurinë juridike; barazinë përpara ligjit) dhe si i tillë është i papajtueshëm me Kushtetutën.

Mbaj qëndrimin se objekt i gjykimit kushtetues, në rastet kur kemi të bëjmë me një kërkesë në rrugë incidentale, është norma, pra rregullimi juridik. Në mënyrë të përmbledhur, gjykata gjykon mbi normën dhe shprehet mbi dispozitën, që është parashikimi tekstual/gjuhësor i normës. Dispozita përbën mjetin e nevojshëm të aksesit të normës në gjykimin e gjykatës, gjykim i cili zhvillohet mbi normën, duke e krahasuar atë me përmbajtjen e parimeve dhe standardeve kushtetuese. Në rast se gjendet përballë një interpretimi të konsoliduar të dispozitës në fjalë, siç është rasti i interpretimit të dhënë me vendimin unifikues, gjykata nuk mundet ta ndryshojë atë duke bërë një interpretim të ndryshëm, që e konsideron të pajtueshëm me Kushtetutën, por ajo mund të gjykojë mbi normën në kuptimin që i është dhënë nga vendimi unifikues. Nëse gjykata vlerëson se kjo normë, sipas interpretimit të dhënë nga vendimi unifikues që konkretizon zbatimin e saj, është e papajtueshme me Kushtetutën, ajo mund të kërkojë jokushtetutshmërinë e normës, duke u nisur nga detyrimi për të mos zbatuar asnjë dispozitë ligjore që çmohet se vjen në kundërshtim me Kushtetutën.

Në përputhje me këtë linjë arsyetimi, është detyrë e gjyqtarit të zakonshëm të përcaktojë objektin dhe standardin kushtetues të cenuar në funksion të inicimit të gjykimit kushtetues. Nëse gjyqtari i zakonshëm vlerëson se mënyra si është interpretuar dhe si zbatohet një dispozitë e caktuar në sistemin ligjor, nëpërmjet një vendimi unifikues, shkakton probleme kushtetutshmërie, ai mund t’i drejtohet Gjykatës duke kundërshtuar dispozitën përkatëse, e cila paraqitet e vesuar nga pikëpamja kushtetuese, si pasojë e interpretimit të dhënë asaj nga Gjykata e Lartë.

Për sa më lart, mendoj se kërkesi nuk legjitimohet, në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës, për të kërkuar kontrollin kushtetues të një vendim unifikues të Gjykatës së Lartë, dhe, për rrjedhojë, kërkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duhet të ishte rrëzuar për këtë shkak.

Anëtar: Sokol Berberi.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 23.2.2012
Doli nga shtypi më 24.2.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 40 lekë